FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 181

Tiranë – E martë, 23 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 18.11.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Trajnimin e Nëpunësve Civilë", të ndryshuar.....	16201
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 688, datë 18.11.2021	Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë.....	16202
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 18.11.2021	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të një anëtari të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.....	16208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 18.11.2021	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Kuçovë, për Njësinë Administrative Kuçovë, të pasurive 6/570 dhe 6/571, me vendndodhje në zonën kadastrale 2310.....	16208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 18.11.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", të ndryshuar..	16212
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 18.11.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", i ndryshuar.....	16213
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 18.11.2021	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Elbasanit.....	16223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 18.11.2021	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Tiranës.....	16223

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 18.11.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i unazës së qytetit Bajram Curri, faza II", Tropojë.....	16223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 18.11.2021	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan, ratifikuar me ligjin nr. 62/2018.....	16227
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 18.11.2021	Për përcaktimin e llojeve të dokumentacionit provues, procedurave të depozitimit, mënyrës së shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, llojeve të programeve të trajnimit të detyrueshëm, periodicitetit të trajnimit, si dhe mënyrës së vlerësimit të aftësive të përfituara gjatë trajnimit për agjentin e tokenit digjital.....	16230
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 702, datë 18.11.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021", të ndryshuar.....	16235
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 18.11.2021	Për disa shtesa në vendimin nr. 162, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit".....	16236
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 12.11.2021	Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore.....	16236
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 28.9.2021	Kërkesat nr. 41411/11 dhe 58014/16, Renaldo Bregu kundër Shqipërisë dhe Natasha Nokshiqi kundër Shqipërisë.....	16285
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 7.10.2021	Kërkesa nr. 47401/15, Myslym Nela kundër Shqipërisë.....	16290
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 7.10.2021	Kërkesa nr. 3824/16, Edmond Zhupa kundër Shqipërisë.....	16292
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 3, datë 12.11.2021	Deklasifikimi plotësisht i informacioneve (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror".....	16293

VENDIM
Nr. 687, datë 18.11.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 138, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSVE CIVILË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 9, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil".

2. Shkronja "f", e pikës 11, të kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"f) lëshon vërtetimin për ndjekjen, me sukses ose jo, të programeve të trajnimit në ASPA;".

3. Në kreun III bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Personat jashtë shërbimit civil, që me iniciativën e tyre dëshirojnë të ndjekin programin e formimit të vazhdueshëm dhe përzgjidhen nga ASPA, për këtë qëllim, paguajnë 3 000 (tre mijë)–7 000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi, në varësi të kohëzgjatjes së kursit.";

b) pas pikës 9 shtohen pikat 9/1 dhe 9/2, me këtë përmbajtje:

"9/1. Nëpunësit e administratës publike jashtë shërbimit civil trajnohen nga ASPA nëpërmjet programit të formimit të vazhdueshëm, për veprimtari administrative të lidhura ngushtësisht me detyrën, trajnime të cilat përcaktohen nga institucioni ku janë të punësuar apo nga institucione të tjera përgjegjëse për fusha të caktuara.

9/2. Nëpunësit, sipas pikës 9/1, të këtij kreu, trajnohen me fonde të buxhetit të shtetit, duke akorduar në buxhetin vjetor të ASPA-s fonde për këtë qëllim. Për të planifikuar fondet e nevojshme, ASPA bashkëpunon me institucionet që kanë nevojën për këto trajnime.".

c) Pas pikës 11 shtohet pika 12, me këtë përmbajtje:

"12. Pagesa për kurs trajnimi llogaritet në përpjesëtim me orët e trajnimit.".

4. Në kreun VI bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1 shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) Kontratë për vlerësimin e cilësisë së kurrikulave dhe materialeve të trajnimit.".

b) Pika 2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"2. Trajnerët me të cilët lidhet kontrata, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij kreu, ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) Trajnerë të kategorisë së ulët, trajnerët që kanë një diplomë "Master i shkencave" ose "Master i arteve" ose "Master professional", të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 3-5 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin;

b) Trajnerë të kategorisë së mesme, trajnerët që kanë një diplomë "Master i shkencave" ose "Master i arteve" ose "Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 6-10 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin, ose trajnerët që kanë një diplomë postmaster apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe, minimalisht, 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin;

c) Trajnerë të kategorisë së lartë, trajnerët që kanë një diplomë "Master i shkencave" ose "Master i arteve" ose "Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 11 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të

ofrojnë trajnimin ose trajnerët që kanë një gradë apo titull shkencor;

ç) Trajnerë të kategorisë së veçantë, trajnerët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. Kanë një diplomë të arsimit të lartë apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. Jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë apo janë kthyer në Shqipëri jo më herët se 2 vjet nga momenti i kontraktimit nga ASPA; dhe

iii. Kanë të paktën 3 vite përvojë pune në institucione/organizata/kompani ndërkombëtare jashtë vendit, të lidhura me fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin.".

5. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Trajnerë me të cilët lidhen kontratat e parashikuara në shkronjat "a", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij kreu, zgjidhen:

a) individët që kanë një diplomë "Master i shkencave" ose "Master i arteve" ose "Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe një përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin e trajnerëve ose do të hartojnë kurrikulat/materialet trajnuese ose do të vlerësojnë cilësinë e kurrikulës së trajnimit dhe materialeve trajnuese, më të madhe se 11 vjet apo kanë një gradë shkencore apo titull akademik; ose

b) individët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. kanë një diplomë të arsimit të lartë apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë apo janë kthyer në Shqipëri jo më herët se 2 vjet nga momenti i kontraktimit nga ASPA; dhe

iii. kanë të paktën 4 vite përvojë pune në institucione/organizata/kompani ndërkombëtare jashtë vendit, të lidhura me fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin e trajnerëve ose do të hartojnë kurrikulat/materialet trajnuese ose do të vlerësojnë cilësinë e kurrikulës së trajnimit dhe materialeve trajnuese.".

6. Në shkronjën "a", të pikës 4, fjalët "… të pikës 1, të kreut V, të këtij vendimi" zëvendësohen me "… të pikës 1, të këtij kreu …".

7. Shkronja "b", e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) për kontratat e parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi të jetë:

i. 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret e parashikuara në shkronjën "a", të pikës 3, të këtij kreu;

ii. 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret parashikuara në shkronjën "b", të pikës 3, të këtij kreu.".

8. Pas shkronjës "b", të pikës 4, shtohet shkronja "b/1", me këtë përmbajtje:

"b/1. Për kontratat e parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për vlerësimin e cilësisë së kurrikulave apo materialeve të trajnimit të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi të jetë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.".

9. Shkronja "c", e pikës 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) në rastet e hartimit apo vlerësimit të cilësisë së kurrikulave apo të materialeve të trajnimit për më pak ose më shumë se 6 orë trajnimi 60-minutëshe pagesa llogaritet në përpjesëtim me orët e trajnimit.".

10. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në shkronjën "a", të pikës 4, të kreut VI, të shtohet një rresht me këtë përmbajtje:

Trajnerë të kategorisë së veçantë	3 000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 688, datë 18.11.2021

PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" dhe të pikave 1, shkronja "a", dhe 2,

të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e pagës mujore dhe vlerat e pagave e të shtesave mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë janë, si më poshtë vijon:

a) paga mujore për gradë është sipas kolonës 3, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi e është pjesë përbërëse e tij, dhe përfaqëson nivelin e pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës;

b) shtesa mujore për natyrë të veçantë pune, për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa mujore mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) shtesa mujore mbi pagë për vjetërsi shërbimi është shtesa që përfiton punonjësi i Gardës së Republikës së Shqipërisë për çdo vit shërbimi. Kjo shtesë aplikohet në përqindje mbi pagën për gradë të gradës "Inspektor" dhe jepet në masën 1% për çdo vit, por jo më shumë se 25 vjet.

2. Për efekt të llogaritjes së shtesës mujore mbi pagë për vjetërsi shërbimi, sipas shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij vendimi, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Forcave të Armatosura, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Policisë së Burgjeve, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

3. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e vjetërsisë në shërbim për efekt pagese janë vitet e sigurimit vullnetar, të vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

4. Punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, të cilët deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi përfitonin pagë mujore më të lartë se ajo e përcaktuar në këtë vendim, do të përfitojnë "ruajtje page", por jo më shumë se dy vjet nga data e fillimit të zbatimit të këtij vendimi.

5. Masa e "ruajtjes së pagës", sipas pikës 4, të këtij vendimi, do të jetë e barabartë me diferencën e pagës mujore që punonjësi përfitonte përpara miratimit të këtij vendimi me pagën mujore sipas përcaktimit të këtij vendimi. Kjo shtesë rillogaritet në çdo rast kur bëhen ndryshimet për pagat për gradë, sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 15.7.2020, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nr. 639, datë 29.7.2020, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë", shfuqizohen.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për Gardën e Republikës së Shqipërisë.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2021.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

PAGA MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë
1	2	3
Për punonjësit e niveli madhor	Drejtues Madhor	125 000
	Drejtues i lartë	115 000
Për punonjësit e nivelit të lartë	Drejtues i parë	109 000
	Drejtues	99 000
Për punonjësit e nivelit të mesëm	Kryekomisar	87 000
	Komisar	72 000
	Nënkomisar	65 500
Për punonjësit e nivelit bazë	Inspektor i parë	54 500
	Inspektor i dytë	52 000
	Inspektor	50 000

Lidhja nr. 2

MASA E SHTESËS MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE, PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr.	Funksionet organike në strukturat e Gardës së Republikës	Masa mujore e shtesës në lekë
1	Drejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës	**40 000**
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës	**35 000**
3	Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit	**30 000**
4	Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e PLSH-së	
5	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
6	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
7	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës dhe familjes së tij, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
8	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
9	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
10	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
11	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
12	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
13	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
14	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit dhe familjes së tij, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
15	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
16	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	

17	Shef njësie, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë Speciale	**25 000**
18	Zëvendësshef njësie, në Njësinë Speciale	
19	Specialist për shërbimet, në Njësinë Speciale	
20	Specialist për stërvitjen dhe trajnimet, në Njësinë Speciale	
21	Shef sektori në Njësinë Speciale	
22	Trup shërbimi special në Njësinë Speciale	
23	Përgjegjës për shërbimin e gatshëm në Njësinë Speciale	
24	Trup shërbimi - shofer në Njësinë Speciale	
25	Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit	**20 000**
26	Zëvendësdrejtor i Drejtorisë për Sigurinë e PLSH-së	
27	Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
28	Shef njësie në Njësinë e Parë	
29	Shef njësie në Njësinë e Tretë	
30	Shef njësie në Njësinë e Katërt	
31	Truprojë për Zëvendëskryeministrin	**17 500**
32	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Prokurorit të Përgjithshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
33	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Prokurorit të Përgjithshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
34	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
35	Truprojë, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
36	Truprojë - shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
37	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
38	Shef i Kabinetit	**15 000**
39	Shef sektori, në Sektorin për sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
40	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
41	Truprojë dhe truprojë-shofer, për personalitetet shtetërore dhe ish-personalitetet e larta shtetërore, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
42	Shef sektori, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
43	Shef seksioni, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
44	Truprojë dhe truprojë-motoçiklist ceremonial, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
45	Shofer, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
46	Zëvendësdrejtor, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
47	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë e drejtuesve të SPAK-ut dhe gjykatave, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
48	Zëvendësshef sektori, në Sektorin e për Sigurinë e Drejtuesve të SPAK-ut dhe gjykatave, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
49	Truprojë dhe truprojë - shofer, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
50	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse	
51	Shef i Qendrës së Aftësimit Profesional	
52	Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore	
53	Shef i Sektorit të Buxhet-Financës	
54	Shef i Sektorit të Analizës	
55	Shef i Sallës Operative	
56	Shef i Sektorit të Prokurimeve	
57	Shef i Sektorit të Informimit të Brendshëm	
58	Zëvendësshef njësie në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt	
59	Shofer për kabinetin në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
60	Specialist për formimin dhe trajnimet, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit	**12 000**
61	Specialist për qarkullimin rrugor, në Drejtorinë e Planifikimit, dhe Kontrollit	
62	Specialist për planifikimin, në Drejtorinë e Planifikimit, dhe Kontrollit	
63	Specialist për komunikimin dhe statistikat	

64	Psikolog
65	Shofer në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit
66	Specialist për shërbimet, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së
67	Specialist për shërbimet e PLSH-së, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së
68	Specialist për stërvitjen dhe transportin, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së
69	Specialist për teknologjinë e informacionit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së
70	Specialist për mjetet lundruese (komandant motoskafi) në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
71	Ndihmëspecialist për mjetet lundruese (marinar) në sektorin e transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
72	Shofer, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së
73	Trup shërbimi, në Sektorin për Sigurinë e PSH-së, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së
74	Specialist për shërbimet, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë
75	Shofer në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë
76	Trup shërbimi në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë
77	Specialist për shërbimet dhe trajnimin, në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë e Tretë
78	Shef sektori, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt
79	Zëvendësshef sektori, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt
80	Shef seksioni, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë e Tretë
81	Trup shërbimi në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Sektorin për Sigurinë e Vendvendosjes së Gardës në Njësinë e Katërt
82	Trup shërbimi ceremonial, në të gjitha strukturat
83	Asistues për PLSH-në
84	Shef sektori, në Sektorin e Policisë Parlamentare
85	Zëvendësshef sektori, në Sektorin e Policisë Parlamentare
86	Trup shërbimi, në Sektorin e Policisë Parlamentare
87	Specialist për shërbimet, në Njësinë e Katërt
88	Shef sektori, për ruajtjen e rezidencave qeveritare e OKV
89	Shofer, në Njësinë e Katërt
90	Specialist dhe ndihmëspecialist i ruajtjes nga incidentet me LE dhe ASHM në të gjitha strukturat
91	Instruktor për qenin eksplozivkërkues
92	Shef sektori, në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës
93	Shef sektori, në Sektorin e Armatimit dhe Pajisjeve
94	Shef seksioni, në Sektorin e për Ruajtjen e Rezidencave e OKV
95	Shef sektori, në Sektorin e Programimit dhe Stërvitjes, në Qendrën e Aftësimit Profesional
96	Shef sektori, në Sektorin e Ruajtjes së Objektit, në Qendrën e Aftësimit Profesional
97	Shef sektori, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
98	Shef sektori, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
99	Shef sektori, në Sektorin e Protokoll-Arkivit
100	Shef sektori (mjek), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
101	Specialist (mjek), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
102	Specialist (kryeinfermier), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
103	Specialist (infermier), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
104	Specialist, në Sektorin e Analizës
105	Specialist, në Sektorin e Informimit të Brendshëm
106	Ndihmëspecialist, në Sektorin e Informimit të Brendshëm
107	Ndihmëspecialist për shërbimin e brendshëm në të gjitha strukturat
108	Specialist në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës
109	Ndihmëspecialist (shofer), në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës
110	Llogaritar për armatimin, në Sektorin e Armatimit dhe Pajisjeve
111	Teknik mirëmbajtjeje, në Sektorin e armatimit dhe pajisjeve
112	Zëvendësshef seksioni, në Sektorin për Ruajtjen e Rezidencave e OKV, në Njësinë e Katërt
113	Trup shërbimi dhe shofer, në Sektorin për Ruajtjen e Rezidencave e OKV, në Njësinë e e Katërt
114	Instruktor për palestrën
115	Specialist në Sektorin e Programimit dhe Stërvitjes, në Qendrën e Aftësimit Profesional
116	Specialist dhe ndihmëspecialist i administrimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse
117	Specialist i shfrytëzimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse

118	Specialist për riparimin e mjeteve, në Sektorin E Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	**10 000**
119	Kolaudator i mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
120	Specialist, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
121	Trup shërbimi në Sektorin e Ruajtjes së Objektit, në Qendrën e Aftësimit Profesional	
122	Specialist, në Sallën operative	
123	Specialist, në Sektorin e Burimeve Njerëzore	
124	Specialist, në Sektorin e Buxhet-Financës	
125	Specialist, në Sektorin e Prokurimeve	
126	Këshilltar në Kabinet	
127	Këshilltar juridik në Kabinet	
128	Asistent në Kabinet	
129	Asistent për zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Gardës së Republikës	
130	Përgjegjës material, në të gjitha strukturat	
131	Ndihmëspecialist për Multimedian	
132	Teknik ndërtimi, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
133	Teknik mirëmbajtje, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
134	Automekanik, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
135	Përgjegjës punëtorie, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
136	Ndihmëspecialist i administrimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
137	Automekanik, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
138	Specialist arkivi, në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
139	Shofer, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	**5 000**
141	Korrier (shofer), në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	

Lidhja nr. 3

MASA E SHTESËS MUJORE PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME PËR SHËNDETIN, PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr.	**Funksionet organike në strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë**	**Masa e shtesës mujore në lekë**
1	**2**	**3**
1	Ndihmëspecialist në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës; Specialist - motorist automekanik, përgjegjës VKT-je, elektricist, elektroaut, baterist, saldator.	**3 000**
2	Mjek; Kryeinfermier; Infermier.	**2 000**
3	Arkivist Protokollist/arkivist	**1 500**

VENDIM
Nr. 689, datë 18.11.2021

PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË NJË ANËTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të z. Albert Nikolla për anëtar të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 690, datë 18.11.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KUÇOVË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KUÇOVË, TË PASURIVE 6/570 DHE 6/571, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 2310

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Kuçovë, për njësinë administrative Kuçovë, të pasurive 6/570 dhe 6/571, me vendndodhje në zonën kadastrale 2310, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim implementimin e projektit "Rikualifikimi i Parkut Industrial Kuçovë".

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike të miratuar me vendimin nr. 662, datë 8.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë së Kuçovës", të ndryshuar.

3. Bashkisë Kuçovë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, t'i tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Kuçovë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Bashkia Kuçovë

FUSHA E PËRDORIMIT: lidhja 1 (Transferim), prona për fushën e infrastrukturës, sportive dhe rekreative (sheshe,lulishte,parqe dhe sherbime publike)

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Numri I Pasurise	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Tot e Pronës (m2)	Sip e Ndertesës (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2310 G-4	6/570	Truall	Llagja nr.2, Blloku "1 Maj"	11300.8	2830	Për zonë rekreative dhe hapësira të gjelbërta	Bashkia Kuçovë	Bashkia Kuçovë	
2	2310 G-4	6/571	Truall	Llagja nr.2, Blloku "1 Maj"	609.2		Për zonë rekreative dhe hapësira të gjelbërta	Bashkia Kuçovë	Bashkia Kuçovë	

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET , DATE 04 /10/2021, QELLIMI: TRANSFERIM

VENDNDODHJA:

Bashkia KUÇOVË, DVASHK/ZVASHK KUÇOVË, ZONA KADASTRALE 2310, NUMRI PASURISE 6/570, DEKS HARTE KV-G-4

TË DHËNAT E PASURISË:

LLOJI PASURISE TRUALL, SIP. PASURISË 11300.8m², SIP. GJURMËS SË NDËRTIMIT= 2830m², NUMRI KATEVE ____, NUMRI PEMËVE 0

x=492488.11
y=4518642.83

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

x=492764.84
y=4518642.83



x=492488.11
y=4518439.34

SH 1: 1000

x=492764.84
y=4518439.34

Nr	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			G/571 ,179 ,138		
2	LINDJE			G/314		
3	JUG			G/135, 458		
4	PERËNDIM			G/145		

REALIZOI PER SUBJEKT SHTETEROR:
EMRI: KRYETARI BASHKISE KUÇOVE
KRESHNIK HAJDARI:
KOMPANIA: BASHKIA KUÇOVE
NIPT: K48504103D
NENSHKRIMI/VULA

REALIZOI PER ASHK:
SPECIALISTI: ERVIN LIKO
NENSHKRIMI:

KONFIRMOI:
PERGJEGJESI/DREJTORI: FERDINAND PUTRO
NENSHKRIMI/VULA:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: D, D
Kode per teknologjine e matjeve: T-terren, Z-Zyre, D-Ortofoto, G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash
PERCAKTIMI KUFIRIT: HK
Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitaret te gjithe, KP-Kufitaret Pjeserisht, PB-perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale

SHENIME TE VECANTA:
Ne administrim Ministria e Ekonomise dhe Energjitikes Shoqeria Petrol Albania SHA

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MAREDHENIET ME KUFITARET
EMRI: SHTET
NENSHKRIMI/VULA:

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimin e kufirit: T-terren, Z-Zyre, D-Ortofoto, G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash, P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitaret te gjithe, KP-Kufitaret Pjeserisht, PB-perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET , DATE 04 /10/2021, QELLIMI: TRANSFERIM

VENDNDODHJA:

Bashkia KUÇOVË, DVASHK/ZVASHK KUÇOVË, ZONA KADASTRALE 2310, NUMRI PASURISE 6/571, DEKS HARTE KV-G-4

TË DHËNAT E PASURISË:

LLOJI PASURISE TRUALL, SIP. PASURISË 609.2m², SIP. GJURMËS SË NDËRTIMIT= m², NUMRI KATEVE , NUMRI PEMËVE 0

x=492488.11
y=4518642.83

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

x=492764.84
y=4518642.83

x=492488.11
y=4518439.34

SH I: 1000

x=492764.84
y=4518439.34

Nr	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI	Rruge+Trotuar	Rruge+Trot	G/134		
2	LINDJE	Sherbim+Banese	Ndertese	G/176		
3	JUG		Truall+Ndertese	G/570		
4	PERËNDIM		Truall+Ndertese	G/570		

REALIZOI PER SUBJEKT SHTETEROR:
EMRI: KRYETARI BASHKISE KUÇOVË
KRESHNIK HAJDARI:
KOMPANIA: BASHKIA KUÇOVË
NIPT: K48504103O
NENSHKRIMI/VULA

REALIZOI PER ASHK:
SPECIALISTI: ERVIN LIKO
NENSHKRIMI:

KONFIRMOI:
PERGJEGJESI/DREJTORI: FERDINAND PUTRO
NENSHKRIMI/VULA:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: O, D
Kode per teknologjine e matjeve: T-terren, Z-Zyre, O-Ortofoto, G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash
PERCAKTIMI KUFIRIT: HK
Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitaret te gjithe, KP-Kufitaret Pjeserisht,
PB-perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale

SHENIME TE VECANTA:
Ne administrim Ministria e Ekonomise dhe Energjitikes Shoqeria Petrol Albania SHA

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MAREDHENIET ME KUFITARET
EMRI: SHTET
NENSHKRIMI/VULA:

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimin e kufirit: T-terren, Z-Zyre, O-Ortofoto, G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash, P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitaret te gjithe, KP-Kufitaret Pjeserisht,
PB-perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale

VENDIM
Nr. 691, datë 18.11.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 887, DATË 24.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR, SI DHE PROCEDURËS SË MIRATIMIT TË LEJEVE TË ZHVILLIMIT/NDËRTIMIT, NË RASTET E FATKEQËSISË NATYRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pikat 3 e 8, 20, 21, pikat 3 e 5, 22, pika 4, 23, pika 4, 25, pika 2, dhe 34, pika 6, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, të kreut I, pas fjalëve "... në rastet e fatkeqësive natyrore, për ..." shtohen fjalët " ... objektet e dëmtuara, ...".

2. Pas pikës 10, të kreut II, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

"11**.** Në bazë të nevojave dhe të situatave që dalin para apo gjatë procesit të zbatimit të punimeve në terren, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të hartojnë dokumentin e rishikuar të planit të detyruar vendor, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së nismës për rishikimin e tij.".

3. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët "... shkronjat "c" dhe "d"..." zëvendësohen me "... shkronjat "c", "d" dhe "e"...";

b) Në pikën 3, fjala "... kriteret ..." zëvendësohet me "... kushtet ...".

4. Në kreun IV bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën "e", të pikës 1, pas fjalëve "... njësitë zbatuese ..." shtohen fjalët "... ose përfituesit e procesit të rindërtimit dhe programeve të tij ...".

b) Shkronja "k", e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"k) rilevimi topografik i pasurive që zhvillohen, shkalla 1:500, i hartuar nga topograf i licencuar.".

c) Shkronja "a", e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e paraqitjes së aplikimit në sistemin *e-Leje*, për lejet e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "ç", të pikës 1, të këtij kreu;".

ç) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Për çdo çështje tjetër lidhur me planifikimin e detyruar vendor e lejet e zhvillimit, sipas parashikimeve të këtij vendimi, kur nuk ka parashikime të posaçme në këtë vendim, zbatohen rregullat e parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", dhe për aq sa është e mundur, por pa rënë ndesh me këtë vendim, edhe parashikimet e legjislacionit në fuqi për planifikimin e zhvillimin e territorit.".

5. Pas kreut IV shtohet kreu V, me këtë përmbajtje:

"V. PROCEDURA E PËRSHPEJTUAR PËR SHQYRTIMIN E MIRATIMIN E CERTIFIKATËS SË PËRDORIMIT

1. Gjatë zhvillimit mbahen aktet e kontrollit për proceset e ndërtimit nga subjektet, persona fizikë dhe juridikë, të pajisur me licencë në fushën e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, të cilat depozitohen për arkivim pranë njësisë vendore, të shoqëruara me një deklaratë noteriale përgjegjësie ose deklaratë përgjegjësie të nënshkruar elektronikisht, të plotësuar nga subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar.

2. Në përfundim të procesit të zhvillimit, dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë përdorimi janë, si më poshtë vijon:

a) kërkesa për certifikatë përdorimi, sipas formatit të aplikimit të përcaktuar në sistemin *e-Leje*, e nënshkruar elektronikisht;

b) autorizim me prokurë nga zhvilluesi për aplikantin (nëse zhvilluesi dhe aplikuesi janë subjekte të ndryshme) ose autorizim i pajisur me nënshkrim elektronik, nëse aplikuesi është subjekt shtetëror;

c) procesverbali i kolaudimit, i hartuar nga kolaudatori/grupi i kolaudimit, i shoqëruar me

licencën/licencat përkatëse, brenda afatit të vlefshmërisë;

ç) relacioni teknik i mbikëqyrësit/mbikëqyrësve për zbatimin e të gjitha disiplinave të punimeve të ndërtimit, shoqëruar nga licencat përkatëse, brenda afatit të vlefshmërisë;

d) aktet e kontrollit të fazave të ndërtimit të shoqëruara me deklaratë noteriale përgjegjësie ose deklaratë përgjegjësie të nënshkruar elektronikisht, të plotësuar nga subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar;

dh) leja e ndërtimit dhe dokumentacioni shoqërues i saj;

e) kontrata e nënshkruar ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërisë/shoqërive ndërtuese, shoqëruar me licencën përkatëse;

ë) deklaratë noteriale përputhshmërie ose deklaratë përgjegjësie të nënshkruar elektronikisht, lëshuar nga subjekti ndërtues, i cili deklaron, nën përgjegjësinë e tij, se objekti është ndërtuar në përputhje të plotë me kushtet e lejes së ndërtimit;

f) situacioni përfundimtar i punimeve;

g) aktkolaudim nga shoqëria tregtare, që ofron shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm në njësinë e vetëqeverisjes vendore;

gj) procesverbali i furnizimit me energji elektrike nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

l) akt teknik nga shërbimi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi në nivel vendor.

3. Aplikuesit përfitues të grantit të rindërtimit për ndërtimin e banesave individuale duhet të paraqesin për pajisjen me leje përdorimi vetëm dokumentet e kërkuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të kreut V, të këtij vendimi, si dhe deklaratë noteriale përputhshmërie ose deklaratë përgjegjësie të nënshkruar elektronikisht, lëshuar nga subjekti ndërtues, i cili deklaron, nën përgjegjësinë e tij, se objekti është ndërtuar në përputhje të plotë me kushtet e lejes së ndërtimit ose aktin përfundimtar të kontrollit të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Kryetari i bashkisë vendos për kërkesat për lëshimin e certifikatës së përdorimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së aplikimit në sistemin *e-Leje*. Në çdo rast, certifikata e përdorimit për të gjitha kategoritë e lejeve të përcaktuara në këtë vendim jepet sipas lejes përkatëse të ndërtimit.".

II. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 692, datë 18.11.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 5, të kreut I, të vendimit nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2021/1278..." zëvendësohen me "... i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2020/607, CFSP 2021/1278 dhe (CFSP) 2021/1800, bashkëlidhur këtij vendimi.".

2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

L 139 I/4 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 4. 5. 2020

VENDIME

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2020/607

i 4 Maj 2020

amendon Vendimin (CFSP) 2019/1720 lidhur me masat ndaluese nën dritën e situatës në Nikaragua

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke patur parasysh Traktatin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti Nenin 29,

Duke patur parasysh propozimin nga Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Marrëdhëniet e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë,

Duke u nisur nga fakti që:

(1) Në 14 Tetor 2019, Këshilli vuri në zbatim Vendimin (CFSP) 2019/17/20(') lidhur me masat kufizuese për shkak të situatës në Nikaragua.

(2) Në 14 Tetor 2019, Këshilli gjithashtu mori parasysh një sërë konkluzionesh nëpërmjet të cilave solli në vëmendje shqetësimin e tij për situatën politike dhe sociale degraduese në Nikaragua dhe censurën e rreptë të represionit nga forcat e sigurisë dhe grupet e armatosura pro-qeverisë ndaj kundërshtarëve politikë, protestuesve, mediave të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile që kanë qënë duke ndodhur që nga Prilli i 2018-s. Unioni gjithashtu konfirmoi vendosmërinë e tij për të përdorur të gjitha instrumentet e tij për të mbështetur një zgjidhje paqësore dhe të negociuar të krizës si dhe qëllimet e tij për të monitoruar nga afër situatën në vend me qëllim që të mund të reagojë ndaj degradimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës.

(3) Këshilli, duke theksuar shqetësimin e tij për situatën e përgjithshme lidhur me të drejtat e njeriut dhe qeverisjes demokratike, vendosi masa kufizuese dhe theksoi se këto masa do të përdoreshin gradualisht dhe me fleksibilitet, dhe që masa më specifike mund të shtohen në rast të një stagnacioni të situatës dhe degradimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe të shtetit të së drejtës.

(4) Për shkak të situatës serioze të vazhdueshme në Nikaragua, 6 persona duhet të përfshihen në listën e personave fizikë dhe juridikë, entiteteve dhe organeve të cilat janë subjekt i masave kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2019/1720.

(5) Aneksi i Vendimit (SFSP) 2019/1720 do të amendohet respektivisht,

KA MARRË KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2019/1720 është amenduar siç është parashtruar në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit të tij në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.*

Bërë në Bruksel, 4 Maj 2020.

Për Këshillin

Presidenti

G.GRLIC RADMAN

(1) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/1720 i 14 Tetor 2019 lidhur me masat kufizuese për shkak të situatës në Nikaragua (OJ L 262, 15.10.2019, fq. 58).

ANEKS

Regjistrimet e mëposhtme janë vendosur nën titullin "Lista e personave fizikë dhe juridikë, entiteteve dhe organeve referuar në Nenin 1 dhe 2' në Ankesin e Vendimit (CFSP) 2019/1720:

	Emri	Informacioni Identifikues	Arsyet	Data e listimit
		4.05.2020 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian		
1.	Ramón Antonio AVELLÁN MEDAL	Datëlindja: 11 Nëntor 1954 Vendlindja: Jinotepe, Nikaragua Numri i Pasaportës: A0008696 Data e lëshimit: 17 Tetor 2011 Data e skadimit: 17 Tetor 2021 Gjinia: mashkull	Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të Nikaraguas (NNP) dhe ish shef i policisë në Masaya. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua, përfshirë dhe koordinimin e shtypjes e protestueve në Masaya në 2018.	4.5.2020
2.	Sonia CASTRO GONZÁLEZ	Datëlindja: 29 Shtator 1967 Vendlindja: Carazo, Nikaragua Numri i Pasaportës : A00001526 Data e Lëshimit: 19 Nëntor 2019 Data e Skadimit: 19 Nëntor 2028 Numër personal: 042290967000ON Gjinia: femër	Këshilltare e posaçme e Presidentit të Nikaraguas për çështjet e shëndetësisë dhe ish Ministre e Shëndetësisë. Përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua, përfshirë bllokimin e aksesit për marrjen e ndihmës mjekësore të urgjencës nga civilët e plagosur të përfshirë në demonstrata dhe urdhërimin e stafit të spitalit për të raportuar demonstruesit që ishin sjellë në spital nga policia.	4.5.2020
3.	Francisco Javier DÍAZ MADRIZ	Datëlindja: 3 Gusht 1961 Gjinia: mashkull	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të Nikaraguas (NNP) që nga 23 Gusht 2018 dhe ish Zëvendës Drejtor i NNP. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua, përfshirë udhëheqjen e forcave të policisë për të ushtruar dhunë ndaj civilëve, përfshirë përdorim të tepruar të forcës, arrestime arbitrare, ndalime dhe tortura.	4.5.2020
4.	Néstor MONCADA LAU	Datëlindja: 2 Mars 1954 Gjinia: mashkull	Këshilltar personal i Presidentit të Nikaraguas për çështjet e sigurisë kombëtare. Në këtë cilësi ai ka qënë direkt i përfshirë dhe përgjegjës për vendimmarrje për çështje të sigurisë kombëtare dhe bërjen e politikave shtypëse të ndërmarra nga Shteti i Nikaraguas ndaj njerëzve që mermin pjesë në demonstrata, përfaqësues të opozitës dhe gazetarë në Nikaragua nga Prilli 2018 e në vijim.	4.5.2020

5.	Luis PÉREZ OLIVAS	Datëlindja : 8 Janar 1956 Gjinia: mashkull	Komisioner i Përgjithshëm dhe Zyrtari kryesor i Ndihmës Ligjore (DAEJ) në qëndrën penitenciare 'El Chipote'. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut përfshirë torturën, përdorimin e tepruar të forcës, keqtrajtim të të ndaluarve dhe forma të tjera degraduese trajtimi.	4.5.2020
6.	Justo PASTOR URBINA	Datëlindja: 29 Janar 1956 Gjinia: mashkull	Kreu i Njësisë të Operacioneve Speciale të Policisë (DOEP). Ai ka qënë i përfshirë direkt në zbatimin e politikave shtypëse kundra protestuesve dhe opozitës në Nikaragua, vecanërisht në Managua. Në këtë kontekst, ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Nikaragua.	4.5.2020

COUNCIL DECISION (CFSP) 2021/1800

of 11 October 2021

amending Decision (CFSP) 2019/1720 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 14 October 2019, the Council adopted Decision (CFSP) 2019/1720 [1], concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua.

(2) Decision (CFSP) 2019/1720 applies until 15 October 2021. On the basis of a review of that Decision, the restrictive measures set out therein should be extended until 15 October 2022.

(3) Decision (CFSP) 2019/1720 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Article 9 of Decision (CFSP) 2019/1720 is replaced by the following:

'Article 9

This Decision shall apply until 15 October 2022 and shall be kept under constant review. It shall be renewed, or amended as appropriate, if the Council deems that its objectives have not been met.'.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 11 October 2021.

For the Council
The President
J. PODGORŠEK

[1] Council Decision (CFSP) 2019/1720 of 14 October 2019 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua (OJ L 262, 15.10.2019, p. 58).

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2021/1800

i datës 11 Tetor 2021

që ndryshon Vendimin (CFSP) 2019/1720 në lidhje me masat kufizuese referuar situatës në Nikaragua

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke patur parasysh Traktatin e Bashkimit Evropian dhe, në veçanti, nenin 29 të tij,

Duke patur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Meqë:

(1) Më 14 tetor 2019, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2019/1720 ([1]) në lidhje me masat kufizuese referuar situatës në Nikaragua.

(2) Vendimi (CFSP) 2019/1720 është i zbatueshëm deri më 15 tetor 2021. Bazuar në një rishikim të atij Vendimi, lipset zgjatja e masave kufizuese të përcaktuara deri më 15 tetor 2022.

(3) Vendimi (CFSP) 2019/1720 duhet kësisoj të ndryshohet përkatësisht,

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Neni 9 i Vendimit (CFSP) 2019/1720 zëvendësohet me sa më poshtë vijon:

'*Neni 9*

Ky Vendim do të jetë i zbatueshëm deri më 15 tetor 2022 dhe do jetë ndën rishikim të vazhdueshëm. Ai do të përtërihet, apo ndryshohet sipas rastit, në rast se Këshilli vlerëson se nuk janë përmbushur objektivat e tij.'.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën pas botimit të tij në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Bërë në Luksemburg, më 11 Tetor 2021.

Për Këshillin
Presidenti
J. PODGORŠEK

[1] Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/1720 i datës 14 Tetor 2019 në lidhje me masat kufizuese referuar situatës në Nikaragua (OJ L 262, 15.10.2019, fq. 58).

DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2020/607

of 4 May 2020

amending Decision (CFSP) 2019/1720 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 14 October 2019 the Council adopted Decision (CFSP) 2019/1720 (1) concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua.

(2) On 14 October 2019 the Council also adopted conclusions in which it recalled its concern at the deteriorating political and social situation in Nicaragua and firm condemnation of the repression by security forces and pro-government armed groups of political opponents, demonstrators, independent media and civil society organisations that had been ongoing since April 2018. The Union also affirmed its determination to use all its instruments to support a peaceful and negotiated solution to the crisis and its intention to monitor the situation in the country closely in order to react to further deterioration of human rights and the rule of law.

(3) The Council, underscoring its concerns with regard to the overall situation in respect of human rights and democratic governance, adopted restrictive measures and noted that those measures would be used in a gradual and flexible manner and that specific designations could be added in the event of a continued stalemate and further deterioration in respect of human rights and the rule of law.

(4) In view of the continuing grave situation in Nicaragua, six persons should be included in the list of natural and legal persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision (CFSP) 2019/1720.

(5) The Annex to Decision (CFSP) 2019/1720 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2019/1720 is amended as set out in the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 4 May 2020.

For the Council
The President
G. GRLIĆ RADMAN

(1) Council Decision (CFSP) 2019/1720 of 14 October 2019 concerning restrictive measures in view of the situation in Nicaragua (OJ L 262, 15.10.2019, p. 58).

ANNEX

The following entries are inserted under the heading 'List of natural and legal persons, entities and bodies referred to in Articles 1 and 2' in the Annex to Decision (CFSP) 2019/1720:

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
'1.	Ramón Antonio AVELLÁN MEDAL	Date of birth: 11 November 1954 Place of birth: Jinotepe, Nicaragua Passport number: A0008696 Issued: 17 October 2011 Expires: 17 October 2021 Gender: male	Deputy Director-General of the Nicaraguan National Police (NNP) and former chief of the police in Masaya. Responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua, including by coordinating the repression of protesters in Masaya in 2018.	4.5.2020
2.	Sonia CASTRO GONZÁLEZ	Date of birth: 29 September 1967 Place of birth: Carazo, Nicaragua Passport number: A00001526 Issued: 19 November 2019 Expires: 19 November 2028 ID number: 042290967000ON Gender: female	Special advisor to the President of Nicaragua on health issues and former Minister of Health. Responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua, including by hindering access to emergency medical assistance for injured civilians involved in demonstrations and ordering hospital staff to report demonstrators who have been brought to hospital by the police.	4.5.2020
3.	Francisco Javier DÍAZ MADRIZ	Date of birth: 3 August 1961 Gender: male	General Director of the Nicaraguan National Police (NNP) since 23 August 2018 and former Deputy General Director of NNP. Responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua, including by leading police forces committing violence against civilians, including excessive use of force, arbitrary arrests and detentions and torture.	4.5.2020
4.	Néstor MONCADA LAU	Date of birth: 2 March 1954 Gender: male	Personal advisor to the President of Nicaragua on national security matters. In this capacity, he has been directly involved in and responsible for decision-making on national security matters and the establishment of repressive policies carried out by the State of Nicaragua against people taking part in demonstrations, opposition representatives and journalists in Nicaragua from April 2018 onwards.	4.5.2020

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
5.	Luis PÉREZ OLIVAS	Date of birth: 8 January 1956 Gender: male	General Commissioner and Legal Assistance Main Officer (DAEJ) in the 'El Chipote' penitentiary centre. Responsible for serious human rights violations, including torture, use of extensive force, mistreatment of detainees and other forms of degrading treatment.	4.5.2020
6.	Justo PASTOR URBINA	Date of birth: 29 January 1956 Gender: male	Head of Police Special Operations Unit (DOEP). He has been directly involved in the implementation of repressive policies against demonstrators and the opposition in Nicaragua, particularly in Managua. In this context, he is responsible for serious human rights violations and for the repression of civil society and democratic opposition in Nicaragua.	4.5.2020'

VENDIM
Nr. 693, datë 18.11.2021

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Spiro Maliqi, prefekt i qarkut të Elbasanit, lirohet nga kjo detyrë.
2. Znj. Majlinda Perriu emërohet prefekt i qarkut të Elbasanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 694, datë 18.11.2021

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Mersin Murataj, prefekt i qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Afrim Qëndro emërohet prefekt i qarkut të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 696, datë 18.11.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I UNAZËS SË QYTETIT BAJRAM CURRI, FAZA II", TROPOJË

1.Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i unazës së qytetit Bajram Curri, faza II", Tropojë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tropojë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 13 425 681 (trembëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 13 425 681 (trembëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tropojë.
5. Vlera për shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt

shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në zyrat e Bashkisë Tropojë.

8. Bashkia Tropojë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tropojë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Tropojë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tropojë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Tropojë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Tropojë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tropojë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Tropojë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I UNAZËS SË QYTETIT BAJRAM CURRI", FAZA II

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Të dhënat mbi pasurinë				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë					Vlera totale në lek	Adresa	Shënime sqaruese
						Shpronësim tokë "truall"			Shpronësim Ndërtesë				
		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m²	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sip. e ndërtesës e konfirmuar nga ASHK-ja (m²)	Vlera e llogaritur me situacion (lek)			
1	Uke Bajram Hysenukaj	1347	7/54-ND	Ndërtesë	41				41	1017487	1017487	Lagjja "Dardania"	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/53
2	Naim Qazim Haklaj	1347	7/53-ND	Ndërtesë	22.8				22.8	623497	623497	Lagjja "Dardania"	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/55
3	Nurie Bajram Hysenukaj Adriana Sadri Boshnjaku Afërdita Sadri Demiraj Alma Sadri Çakraj Arben Sadri Hysenukaj	1347	7/79	Godinë	34.16	34.16	1873	63982	34.16	988 644	1052626	Lagjja "Dardania"	
4	Kreshnik Petrit Katana Jutbina Petrit Katana Juliana Petrit Katana Bekim Petrit Katana	1347	7/57-ND	Ndërtesë	57				57	1161153	1161153	Lagjja "Dardania"	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/57
5	Kujtim Hamez Osmani Astrit Hamez Osmani	1347	7/211-ND	Ndërtesë	28				28	760359	760359	Lagjja "Dardania"	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/211
6	Kujtim Hamez Osmani Astrit Hamez Osmani	1347	7/213-ND	Ndërtesë	33				33	835256	835256	Lagjja "Dardania"	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/213
7	Bute Selim Neziraj	1347	7/56-ND	Ndërtesë	17.76				17.76	548793	548793	Lagjja "Dardania"	Ndodhet në truallin me nr. pasurie 7/56
8	Shkëlzen Qazim Gjeçaj	1347	7/66	Godinë	50.9	50.9	1873	95336	50.9	1358582	1453918	Lagjja "Dardania"	Bllokohet pas në favor të shoqërisë "FAF"
9	Gani Binak Malizi	1347	7/99	Godinë	85.38	85.38	1873	159917	85.38	1928978	2088895	Lagjja "Dardania"	Bllokohet pas në favor të shoqërisë "FAF"
10	PPV	1347	7/67	Godinë	100	100	1873	187300	54	1092496	1279796	Lagjja "Dardania"	Posedohet nga Agim Motina
11	Kadri Sokol Mustafaj Hamdi Sokol Mustafaj Isa Sokol Mustafaj	1347	7/70	Truall	431	431	1873	807263			807263	Lagjja "Dardania"	Mbi këtë pasuri janë 2 ndërtime pa leje
12	Bedri Haxhi Islamukaj	1347	7/92	Truall	250	34.23	1873	64113			64113	Lagjja "Dardania"	Ndalohen veprimet mbi pasurinë
13	Shtet	1347	7/54	Truall	119	119	1873						
14	Shtet	1347	7/53	Truall	51	51	1873						
15	Shtet	1347	7/57	Truall	82	82	1873						
16	Shtet	1347	7/56	Truall	33	33	1873						
17	Shtet	1347	7/211	Truall	51	51	1873						
18	Shtet	1347	7/213	Truall	51	51	1873						
19	Saimir Ahmet Malaj Enida Sadik Malaj	1347	10/42	Truall	1500	75	1873	140475			140475	Lagjja "Partizani"	
20	Halil Mal Gjongecaj	1347	10/27/9	Truall	837	75	1873	140475			140475	Lagjja "Partizani"	

21	Halil Mal Gjongecaj	1347	10/27/10	Truall	1141	95	1873	177935			177935	Lagjja "Partizani"	
22	Lulzim Adem Rrahmanaj Zeqir Sali Bushgjokaj	1347	10/27/12	Truall	2270	220	1873	412060			412060	Lagjja "Partizani"	
23	Skënder Ahmet Mella Lirie Ahmet Mulaj Azgan Ahmet Mella	1347	10/27/3	Truall	1236	115	1873	215395			215395	Lagjja "Partizani"	
24	Raze Cole Boshnjaku Shpëtim Idris Gjongecaj Dea Fatmir Gjongecaj Bekim Fatmir Gjongecaj Lida Idriz Kuçana Teuta Veli Hajdari	1347	10/27/2	Truall	491.5	35	1873	65555			65555	Lagjja "Partizani"	
25	Besnik Ahmet Alia	1347	10/27/1	Truall	723	15	1873	28095			28095	Lagjja "Partizani"	
26	Saimir Ahmet Malaj	1347	10/195	Truall	1155	250	1873	468250			468250	Lagjja "Partizani"	
27	Besnik Ahmet Alia	1347	10/21/1	Truall	1088	45	1873	84285			84285	Lagjja "Partizani"	
							Vlera totale paraprake	**3110435**			**13425681**		

Shënim: 1. Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë truall" është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Vlerësimi i pasurisë "Ndërtesë" është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000.

VENDIM
Nr. 697, datë 18.11.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID), PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË–ELBASAN, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 62/2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan, ratifikuar me ligjin nr. 62/2018, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

OPEC FUND
for International Development

Fondi OPEC
për Zhvillim Ndërkombëtar

Znj. Anila Denaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Republika e Shqipërisë
Email: info@financa.gov.al

4 gusht 2021

Lënda: Mbi Projektin e punimeve për riparime emergjente të Rrugës Tiranë- Elbasan, Huaja e Fondit OPEC 13406, Zgjatja e Datës së Mbylljes së Huasë.

Shkëlqesia Juaj,

Dëshiroj t'i referohem letrës së Shkëlqesisë Suaj të datës 28 korrik 2021, ku kërkohet të merret në konsideratë një zgjatje e datës së mbylljes për tërheqjen e të ardhurave për huanë e përmendur.

Pas vlerësimit tonë të kërkesës së paraqitur, kam kënaqësinë të informoj Shkëlqesinë Tuaj se Fondi OPEC nuk ka asnjë kundërshtim për zgjatjen e propozuar të datës së mbylljes së huasë deri më 31 janar 2022, për të lejuar përpunimin e disbursimeve përfundimtare të huasë.

Kam besim se shtyrja do të garantojë përfundimin me sukses të aktiviteteve të projektit.

Me konsideratën time më të lartë,
Nënshkrimi

Abdulhamid Alkhalifa
Drejtor i Përgjithshëm

Fondi OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar . P. O Box 995. 111 Vienë. Austri
Tel: +43-1-515 64 -164; 165; . Faks +43-1-513 28 95 . Email Director-General@opecfund.org . www.opecfund.org

Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar

ANEKS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKTI I PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN

NDRYSHIMI I DYTË I SKEDULIT 2

ALOKIMI I HUASË

1. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit OPEC, tabela më poshtë përcakton komponentët që do të financohen nga të ardhurat e Huasë, shpërndarjen e shumave të Huasë për secilin komponent dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që do të jenë financuar, në lidhje me secilin komponent:

Komponenti	Shuma e Huasë e alokuar (e shprehur në dollarë)	Përqindja e Shpenzimeve Totale që do të Financohen
(1) Punime Civile	13,249,957	26.92
(2) Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Konsulencës	2,559,816	42.47
(3) Menaxhim Projekti	190,227	11.43
Totali	16,000,000	

2. Pavarësisht shpërndarjes së një shume të Huasë ose përqindjeve të disbursimit të përcaktuara në tabelën në paragrafin 1 më sipër, nëse Fondi OPEC ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme se shuma e Huasë alokohet për ndonjë komponent, do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të të gjitha shpenzimet në atë komponent, Fondi OPEC mund të njoftojë Huamarrësin : (i) të rialokojë në një komponent të tillë, në masën që kërkohet për të përmbushur mungesën e vlerësuar, të ardhurat e Huasë të cilat më pas u ndanë për një komponent tjetër dhe të cilat sipas opinionit të Fondit OPEC, nuk janë të nevojshme për të përballuar shpenzimet e tjera; dhe (ii) nëse një rialokim i tillë nuk mund të përmbushë plotësisht mungesën e vlerësuar, zvogëloni përqindjen e disbursimit të zbatueshme për shpenzime të tilla, në mënyrë që shpenzimet e mëtejshme në lidhje me këtë komponent të mund të vazhdojnë derisa të jenë kryer të gjitha shpenzimet e saj.

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Fondi OPEC
për Zhvillim Ndërkombëtar

Znj. Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

17 gusht 2021

Lënda: Ndryshimi i Dytë i Skedulit 2 të Marrëveshjes së Huasë të Fondit OPEC Nr. 13406P mbi Projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë- Elbasan

Shkëlqësi,

Ky dokument i referohet letrës së Shkëlqesisë Suaj Nr. 10501, të datës 28 korrik 2021, duke kërkuar që Fondi OPEC të ndryshojë shpërndarjen e shumave dhe përqindjet e financimit në Skedulin 2, të Marrëveshjes së Huasë. Në përgjigje të saj, si dhe duke marrë parasysh arsyetimin e dhënë në lidhje me këtë, kam kënaqësinë të përcjell miratimin e Fondit OPEC për propozimin e ndryshimit.

Si rrjedhojë, Skeduli i dytë i Rishikuar, i përfshirë në Shtojcën e kësaj letre, do të zëvendësojë Skedulin 2 të Marrëveshjes së Huasë. Ky ndryshim hyn në fuqi dhe efekt që nga data e kësaj letre.

Me konsideratën time më të lartë,
Nënshkrimi

Abdulhamid Alkhalifa
Drejtor i Përgjithshëm

NS/pw
Fondi OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar . P. O Box 995. 111 Vienë. Austri
Tel: +43-1-515 64 -164; 165; . Faks +43-1-513 28 95 . Email Director-General@opecfund.org . www.opecfund.org

VENDIM
Nr. 699, datë 18.11.2021

PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË DOKUMENTACIONIT PROVUES, PROCEDURAVE TË DEPOZITIMIT, MËNYRËS SË SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT, LLOJEVE TË PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM, PERIODICITETIT TË TRAJNIMIT, SI DHE MËNYRËS SË VLERËSIMIT TË AFTËSIVE TË PËRFITUARA GJATË TRAJNIMIT PËR AGJENTIN E TOKENIT DIGJITAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 29, të ligjit nr. 66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e llojit të dokumentacionit provues, mënyrës së shqyrtimit e të vlerësimit të dokumentacionit, si dhe llojeve të programeve të trajnimit të detyrueshëm, periodicitetit të trajnimit e mënyrës së vlerësimit të aftësive të përfituara gjatë trajnimit për subjektet që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital.

Neni 2
Fusha e veprimtarisë

Ky vendim zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë, që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si agjent i licencuar i tokenit digjital në Republikën e Shqipërisë, për klientë që ndodhen brenda territorit të saj ose nga Republika e Shqipërisë, për klientë që ndodhen jashtë saj.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë vendim, përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3, të ligjit nr.66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **"Autoritet"**, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

b) "***e-Learning***", programet e trajnimit *online* që mundësojnë pjesëmarrjen në distancë;

c)**"Fushë e ekspertizës"**, të gjitha fushat e trajnimit të përcaktuara në programin e detyrueshëm të trajnimit, sipas nenit 7, të këtij vendimi;

ç) **"Kërkesë për njohje"**, çdo kërkesë për njohjen e një ose më shumë PTD-ve, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 11, të këtij vendimi;

d) **"Ligji"**, ligji nr.66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë";

dh) **"Njohje"**, procedura e vlerësimit të një PTD-je me qëllim garantimin e përshtatshmërisë së saj për trajnimet e ofruara;

e) **"Personel kyç"**, çdo person fizik/individ, i cili mban një ose më shumë nga funksionet e mëposhtme në shoqërinë e subjektit kërkues/agjentit TD:

i. drejtori i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;

ii. drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm;

iii. drejtori i Departamentit të Financës;

iv. drejtori i Departamentit të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

v. drejtori i Departamentit të Përputhshmërisë;

vi. zyrtari përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

ë) **"Program i trajnimit të detyrueshëm (PTD)"**, të gjitha kurset, seminaret e trajnimet, të cilat kanë për qëllim certifikimin e njohurive dhe aftësive të subjekteve që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si agjent TD;

f) **"Tarifa e njohjes"**, tarifa që paguhet për marrjen e vërtetimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për kryerjen e një ose më shumë PTD-je;

g) **"Periudhë trajnimi"**, periudha kohore përgjatë së cilës duhet të kryhet PTD-ja.

KREU II
LLOJET E DOKUMETACIONIT PROVUES DHE PROCEDURA E DEPOZITIMIT, SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT TË TIJ

Neni 4
Llojet e dokumentacionit provues

1. Krahas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, subjekti kërkues për licencë agjenti TD, për të provuar se ka aftësitë dhe njohuritë e duhura teknike dhe ligjore për të ushtruar veprimtarinë e lidhur me agjentët TD, duhet të depozitojë edhe dokumentacionin provues lidhur me kryerjen e programeve të trajnimit të detyrueshëm, si më poshtë vijon:

a) vërtetimin për kryerjen e PTD-së, sipas përcaktimeve të nenit 11, të këtij vendimi;

b) mandatin e pagesës së tarifës së njohjes së PTD-së;

c) fotokopjen e kartës së identitetit të punonjësve, të cilët u janë nënshtruar programeve të trajnimit të detyrueshëm.

Neni 5
Procedura e depozitimit të dokumentacionit provues

1. Dokumentacioni provues i përcaktuar në nenin 4, të këtij vendimi, depozitohet pranë Autoritetit në rrugë shkresore ose dorazi, brenda periudhës përkatëse të trajnimit, të përcaktuar në nenin 10, të këtij vendimi.

2. Kërkesa përkatëse nga ana e subjektit kërkues për vërtetimin e kryerjes së PTD-së mund të përfshijë një ose më shumë PTD.

Neni 6
Mënyra e shqyrtimit dhe e vlerësimit të dokumentacionit provues

1. Dokumentacioni provues merret në dorëzim nga Autoriteti, i cili, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike vlerëson nëse ky dokumentacion është në përputhje me parashikimet e nenit 4, të këtij vendimi.

2. Nëse dokumentacioni i dorëzuar ka të meta ose nuk është i plotë, Autoriteti i kërkon subjektit të interesuar plotësimin dhe/ose saktësimin e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike.

3. Pas shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacioni provues, Autoriteti njofton subjektin lidhur me vendimin për miratimin ose jo të kërkesës së tij, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij vendimi.

4. Ndaj vendimit të Autoritetit, subjekti i interesuar mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë gjykatës kompetente që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga e nesërmja e marrjes së vendimit.

KREU III
PROGRAMET E TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM

Neni 7
Llojet e programeve të trajnimit të detyrueshëm

1. Programi i trajnimit të detyrueshëm përbëhet nga aktivitete trajnuese dhe edukative, të cilat janë njohur ose zhvilluar nga Autoriteti, me qëllim përmirësimin e detyrueshëm të aftësive dhe përditësimin e njohurive të subjekteve kërkuese dhe agjentit TD.

2. PTD-të organizohen në disa lloje:

a) kurse;

b) seminare; dhe

c) konferenca.

3. Kurset, seminaret dhe konferencat synojnë përmirësimin e përditësimin e vazhdueshëm të njohurive të subjekteve kërkuese dhe/ose agjentit TD në fushën e tregjeve financiare, të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, dhe kategorizohen në fushat, si më poshtë vijon:

a) ligjshmëria, përputhshmëria dhe çështjet rregullatore lidhur me teknologjinë e regjistrave të shpërndarë;

b) financa, duke përfshirë këtu inxhinierinë financiare të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë;

c) teknologjia e informacionit dhe siguria kibernetike.

4. Lista e llojeve të PTD-ve të njohura aktualisht nga Autoriteti janë listuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo listë përditësohet nga Autoriteti të paktën 1 (një) herë në vit, brenda muajit dhjetor.

Neni 8
Metodologjia e trajnimit të detyrueshëm

1. PTD-të zhvillohen në formën e leksioneve, kurseve dhe seminareve *online* nëpërmjet kurikulave, të cilat përbëhen nga tekste akademike, trajnime, *live streaming*, leksione të regjistruara, *e-Learning*.

2. Për metodologjinë e trajnimit, stafi akademik, i cili ofron PTD, duhet:

a) të zhvillojë një metodë ndërvepruese mësimdhënieje;

b) të bëjë përpjekje për të ruajtur një ekuilibër mes trajtimit teorik dhe atij praktik të çështjeve që janë objekt diskutimi, ku prioritet të kenë aspektet praktike;

c) të kujdeset për ndërhyrje konstruktive, të shpërndara dhe jodominuese, duke u lënë hapësirë të bollshme diskutimeve nga ana e pjesëmarrësve;

ç) të ketë aftësinë për të kombinuar disa metoda të mësimdhënies (prezantimi verbal, prezantim me shkrim, puna në grup, pyetjet, përdorimin e mjeteve audiovizive etj.);

d) të ketë aftësi për të prezantuar materialin pa ndonjë mbështetje dokumentare e për të përgatitur materialet burimore të nevojshme, mbështetjen e aspekteve teorike dhe praktike, për të vëzhguar nivelin e duhur të ndërveprimit dhe mbështetjen e metodave të trajnimit, qëllimit e tematikës së prezantimeve dhe për të qëndruar brenda kohës së përcaktuar për një prezantim;

dh) të bashkëpunojë me pedagogët e tjerë që mund të jenë të përfshirë në të njëjtin trajnim ose tematikë.

Neni 9
Përzgjedhja e programeve të trajnimit të detyrueshëm

1. Subjektet kërkuese për licencë ose agjent TD kanë detyrimin për të marrë pjesë në PTD, të cilat mbulojnë secilën prej fushave të përcaktuara nenin 7, të këtij vendimi.

2. PTD-të duhet të ndiqen nga zyrtarët e agjentit TD ose të subjektit kërkues, të listuar, si më poshtë vijon:

a) administratori;

b) anëtarët e këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit;

c) personeli kyç.

3. PTD-të mund të zhvillohen brenda ose jashtë Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Periodiciteti i trajnimeve të detyrueshme

1. Në përputhje me pikën 8, të nenit 29, të ligjit, agjenti TD dorëzon pranë Autoritetit, brenda muajit të parë të çdo viti kalendarik, certifikatat ose dokumentet përkatëse, që vërtetojnë pjesëmarrjen e përfundimin me sukses të PTD-së në secilën prej fushave të përcaktuara në nenin 7, të këtij vendimi.

2. Periudha e trajnimit për agjentin TD fillon nga data e marrjes së licencës deri në:

a) fundin e vitit kalendarik;

b) dhe në vijim për çdo vit kalendarik pasardhës.

3. Autoriteti publikon listën e miratuar të PTD-ve, 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike përpara fillimit të çdo periudhe trajnimi. Kjo listë përditësohet periodikisht të paktën 1 (një) herë në vit.

Neni 11
Mënyra e vlerësimit të aftësive të përfituara nga PTD-ja

1. Pas përfundimit të PTD-së në secilën prej fushave të listuara në nenin 7 të këtij vendimi, subjekti kërkues ose agjenti TD dorëzon pranë Autoritetit kërkesën për t'u pajisur me vërtetimin e kryerjes së PTD-së, duke bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm:

a) certifikatën ose dokumentin përkatës, që vërteton përfundimin me sukses të PTD-ve të listuara në shtojcën 1, të këtij vendimi, në secilën prej fushave të përcaktuara në të;

b) listën e notave, në rast se është e aplikueshme;

c) mandatin e pagesës së tarifës së njohjes së PTD-së;

ç) fotokopje të kartës së identitetit të secilit pjesëmarrës në PTD, si dhe pozicionin e tyre brenda strukturës së shoqërisë së subjektit kërkues / agjentit TD.

2. Autoriteti shqyrton kërkesën e dorëzuar sipas pikës 1 të këtij neni, dhe vendos, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve lidhur me pajisjen e subjektit me vërtetimin përkatës. Vërtetimi lëshohet në emër të subjektit kërkues ose të agjentit TD, sipas rastit.

3. Kur subjekti ka përfunduar 1 (një) ose më shumë PTD, të cilat nuk janë të përfshira në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, Autoriteti e pajis subjektin me vërtetimin përkatës vetëm në rastet kur PTD-ja përmbush minimalisht kriteret e mëposhtme:

a) certifikata ose vërtetimi për përfundimin e studimeve të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura/të akreditуara apo institucione të autorizuara në vendin e origjinës;

b) programi mësimor i PTD-së të jetë i fokusuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë dhe të përfshijë 1 (një) ose më shumë nga fushat e përcaktuara në nenin 7 të këtij vendimi;

c) plani mësimor të përmbajë të paktën 20 (njëzet) orë mësimdhënieje;

ç) të ketë të punësuar të paktën 2 (dy) ekspertë në cilësinë e trajnuesve për secilën nga fushat që ofrohet PTD-ja, të cilët përmbushin këto kritere:

i. zotërojnë një diplomë të nivelit "Master shkencor" ose të barasvlefshme, në fushat përkatëse për të cilat ofrohet PTD-ja;

ii. kanë përvojë akademike për të paktën 3 (tre) vjet;

d) të ketë të paktën 20 (njëzet) pjesëmarrës të regjistruar në PTD-në përkatëse;

dh) ofruesi i PTD-së të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në ushtrimin e veprimtarisë së mësimdhënies e të trajnimeve në 1 (një) ose më shumë nga fushat e përcaktuara në nenin 7, të këtij vendimi.

3. Agjenti i TD-së i licencuar dorëzon pranë Autoritetit vërtetimin për kryerjen e PTD-së për periudhën pararendëse të trajnimit brenda muajit të parë të çdo viti.

4. Në rastet kur një nga personat, i cili ka përfunduar me sukses PTD-në, largohet nga funksionet e përcaktuara në strukturën e shoqërisë së subjektit dhe ky i fundit nuk ka në strukturën e shoqërisë së tij individë të tjerë që kanë përfunduar trajnimin në ato fusha të caktuara, atëherë subjekti njofton Autoritetin, me shkrim, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e largimit të tij. Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e largimit, subjekti kërkues ose agjenti TD plotëson vendin vakant, duke emëruar individë që kanë përfunduar me sukses PTD-të në fushën e caktuar.

5. Mospajisja me vërtetimin për kryerjen e PTD-së, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, përbën shkak për refuzimin e kërkesës për licencimin ose revokimin e licencës së agjentit TD.

6. Autoriteti ka të drejtë të bëjë verifikimet përkatëse për vërtetësinë dhe origjinalitetin e dokumenteve të dorëzuara nga subjekti kërkues.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12
Të fundit

1. Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM, TË NJOHURA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Ofruesi	Emri i PTD-së	Venndodhja	Ligjshmëria dhe çështje rregullatore	Financë	Teknologjia e Informacionit
INSEAD	***Blockchain Revolution Specialization***	*Online*			✔
MIT Sloan	***Blockchain Technologies: Business Innovation and Application***	*Online*			✔
MIT Media Lab	***Cryptocurrency***	*Online*	✔		✔
University of Oxford	***Oxford Blockchain Strategy Programme***	*Online*	✔	✔	✔

LSE	***Cryptocurrency & Disruption***	*Online*	✔	✔	✔
NYU*	***Fintech MBA****	Nju-Jork, SHBA			✔
SDA Bocconi	***The Blockchain Journey***	*Online*			✔
University of Nicosia*	***Master of Science in Digital Currency****	*Online*	✔	✔	✔
AICPA	***Blockchain Fundamentals for Accounting and Finance Professionals Certificate***	*Online*		✔	✔
Consensys	***Academy courses on blockchain***	*Online*			✔
B9Lab	***Ethereum Developer / Ethereum QA Engineer Course***	*Online*			✔
INSEAD	***Introduction to blockchain technologies***	*Online*		✔	✔
Princeton University	***Bitcoin and cryptocurrency technologies***	*Online*		✔	✔
Wharton University of Pennsylvania	***Fintech revolution executive education program***	*Online*		✔	✔
Berkeley Executive Education	***Berkeley Fintech education program***	*Online*		✔	✔
University of Pennsylvania	***Fintech foundation and applications***	*Online*		✔	
Harvard Business School	***Fintech Executive Education Program***	*Online*		✔	
University of Cambridge	***Fintech Innovation Executive Education Program***	*Online*		✔	
University of Hong Kong	***Fintech Professional Certificate Program***	*Online*		✔	✔

* Programet e trajnimit të detyrueshëm të ofruara nga *New York University* dhe *University of Nicosia* do të konsiderohen të njohura nga ana e Autoritetit, vetëm pasi diploma e përfituar nga subjekti t'u jetë nënshtruar procedurave të njohjes e të njësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për njohjen dhe njësimin e diplomave universitare.

VENDIM
Nr. 702, datë 18.11.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2021", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca 2, bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet, për vitin 2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 2
BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2021

Institucionet	(Buxheti në 000 lekë sipas artikujve)						Totali
	art.600	art.601	art.602	art. 602 PPP laboratorë	art.604	rezervë	
BERAT	315,300	47,200	170,000	33,500			566,000
BULQIZË	84,900	13,170	30,000	0			128,070
DELVINË	42,370	6,110	7,500	0			55,980
DEVOLL	53,510	8,330	11,000	0			72,840
DIBËR	283,400	44,470	155,000	0			482,870
ELBASAN	475,400	73,970	254,750	51,063			855,183
FIER	431,500	64,100	296,750	84,702			877,052
GRAMSH	146,000	20,170	37,000	0			203,170
GJIROKASTËR	264,600	36,250	134,000	0			434,850
HAS	51,300	7,760	15,000	0			74,060
KAVAJË	126,445	19,690	29,300	0			175,435
KOLONJË	88,550	13,350	20,000	0			121,900
KORCË	480,200	69,300	288,200	36,725			874,425
KRUJË	154,400	20,630	36,000	0			211,030
KUÇOVË	71,300	10,500	18,000	0			99,800
KUKËS	303,800	42,150	120,000	0			465,950
KURBIN	86,280	14,330	32,000	0			132,610
LEZHË	292,500	42,500	152,000	29,382			516,382
LIBRAZHD	158,450	24,700	51,000	0			234,150
LUSHNJË	258,700	38,240	115,000	18,506			430,446
MALËSI E MADHE	24,750	3,770	6,500	0			35,020
MALLAKASTËR	44,400	8,050	13,000	0			65,450
MAT	143,080	21,850	36,000	0			200,930
MIRDITË	113,450	17,460	33,000	0			163,910
PEQIN	38,000	6,200	9,450	0			53,650
PËRMET	80,800	13,100	35,000	0			128,900
POGRADEC	184,900	27,700	77,000	0			289,600
PUKË	103,100	15,150	38,000	0			156,250
SARANDË	178,150	24,900	146,000	6,443			355,493
SKRAPAR	88,650	13,990	16,790	0			119,430
SHKODËR	612,400	91,400	265,000	28,015			996,815
TEPELENË	95,800	14,700	20,000	0			130,500
QSUT	2,999,600	409,250	4,644,525	674,713			8,728,088
SUOGJ "MBRETËRESHA GERA	305,100	46,600	280,000	13,775			645,475
SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	260,300	40,550	205,800	17,775			524,425
SU "SHEFQET NDROQI"	712,500	60,680	853,000	59,087			1,685,267
SU TRAUMA	163,900	22,150	210,000	39,159			435,209
TROPOJË	122,700	17,500	37,000	0			177,200
VLORË	465,600	70,050	374,750	8,000			918,400
MEMORIAL FIER	0	0	0	0	300,000		300,000
DURRËS	0	0	0	37,000	0		37,000
Paketat e shërbimeve	0	0	0	0	1,587,880		1,587,880
Transferta për individët (mj	0	0	0	0	20,000		20,000
Trajtime me VKM	0	0	0	0	20,000		20,000
Pagesa të shërbimeve PPP	0	0	0	0	2,318,982		2,318,982
rezervë	0	0	0	0	0	30,000	30,000
Totali	10,906,085	1,541,970	9,273,315	1,137,845	4,246,862	30,000	27,136,077

VENDIM
Nr. 704, datë 18.11.2021

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 162, DATË 2.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RREGULLAT, PROCEDURAT DHE MËNYRAT E VËNIES NË DISPOZICION TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË ZONAT ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 35, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 162, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 4, të kreut I, shtohen pikat 4.1 dhe 4.2, me këtë përmbajtje:

"4.1 Në rastin e investitorëve strategjikë, sipas ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nuk zbatohet procedura e përcaktuar në kreun II, të këtij vendimi, për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit. Vënia në dispozicion e këtyre pasurive bëhet, si më poshtë vijon:

a) Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) miraton paraprakisht vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit për investitorët strategjikë, si masë mbështetëse për realizimin e investimit, në përputhje me ligjin nr. 55/2015, të ndryshuar.

b) Vendimi i KIS-it dhe dokumentacioni shoqërues i përcillen ministrisë përgjegjëse për turizmin nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

4.2 Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, miraton vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, sipas pikës 4.1, të kreut I, të këtij vendimi.".

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 6, datë 12.11.2021

MBI KONTROLLIN TEKNIK TË MJETEVE RRUGORE[1]

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 79, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 234, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të direktivës 2014/45/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 3.4.2014, "Mbi kontrollin teknik periodik të automjeteve dhe rimorkiove të tyre dhe shfuqizimin e direktivës 2009/40/KE", ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

KAPITULLI I
LËNDA E SUBJEKTIT, PËRKUFIZIMET DHE FUSHËVEPRIMI

Neni 1
Lënda e subjektit

Ky udhëzim përcakton kërkesat minimale për një regjim të kontrolleve teknike periodike të mjeteve rrugore të përdorura në rrugë publike.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Ky udhëzim zbatohet për mjetet me një shpejtësi të projektuar që tejkalon 25 km / orë të kategorive të mëposhtme:

a) mjetet motorike të projektuara dhe të ndërtuara kryesisht për transportin e personave dhe bagazheve të tyre, që përfshijnë jo më shumë se tetë vende të ulura, përveç pozicionit të uljes së shoferit – kategoria e mjetit M1;

[1] Ky udhëzim është përafruar plotësisht me direktivën 2014/45/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 3 prill 2014 "Mbi kontrollin teknik periodik të automjeteve dhe rimorkiove të tyre, dhe që shfuqizon direktivën 2009/40/KE". Numri CELEX 32009L0103, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 127, datë 29.04.2014, faqe 51–128.

b) mjetet motorike të projektuara dhe të ndërtuara kryesisht për transportin e personave dhe bagazheve të tyre, që përfshijnë më shumë se tetë vende të ulura përveç pozicionit të uljes së shoferit – kategoritë e automjeteve M2 dhe M3;

c) mjetet motorike të projektuara dhe të ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave, me një masë maksimale që nuk tejkalon 3,5 tonë – kategoria e mjetit N1;

ç) mjetet motorike të projektuara dhe të ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave, me një masë maksimale që tejkalon 3,5 tonë – kategoritë e mjeteve N2 dhe N3;

d) rimorkiot e projektuar dhe ndërtuar për transportin e mallrave ose personave, si dhe për akomodimin e personave, me një masë maksimale që tejkalon 3,5 tonë – kategoritë e mjeteve O3 dhe O4;

dh) mjetet me dy ose tri rrota – kategoritë e mjeteve L3, L4, L5 dhe L7, me një zhvendosje motorike prej më shumë se 125 cm^3;

e) traktorë me rrota të kategorisë T5, përdorimi i të cilëve kryhet kryesisht në rrugë publike me një shpejtësi maksimale të projektuar që tejkalon 40 km/orë.

2. Përjashtohen mjetet e mëposhtme të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë nga zbatimi i këtij udhëzimi:

a) mjetet që operojnë ose përdoren në kushte të jashtëzakonshme dhe mjete të cilat asnjëherë ose rrallëherë përdoren në rrugë publike, siç janë mjetet me interes historik ose mjetet e garave;

b) mjetet e mbuluara me imunitet diplomatik;

c) mjetet e përdorura nga forcat e armatosura, forcat përgjegjëse për rendin dhe ligjin, shërbimet e zjarrit, shërbimin e mbrojtjes civile dhe shërbimet e emergjencës ose shpëtimit;

ç) mjetet që përdoren për qëllime bujqësore, hortikulturore, pyjore, fermere ose peshkimi vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kryesisht në terrenin ku zhvillohet një veprimtari e tillë, duke përfshirë rrugët bujqësore, rrugët pyjore ose fushat bujqësore;

d) mjetet e përdorura ekskluzivisht në ishujt e vegjël ose në zonat me popullsi të pakët;

dh) mjete të specializuara që transportojnë pajisje cirku dhe të parqeve të lojërave, me një shpejtësi maksimale të projektuar, që nuk i kalon 40 km/orë dhe vepron vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizimet

Përkufizimet e mëposhtme zbatohen vetëm për qëllimet e këtij udhëzimi:

1. "mjet" nënkupton çdo mjet motorik, që nuk është hekurudhor ose rimorkio e tij;

2. "mjet motorik" nënkupton çdo mjet të drejtuar nga rrotat që lëviz me mjetet e veta me shpejtësi maksimale të projektuar që tejkalon 25 km/orë;

3. "rimorkio" nënkupton çdo mjet jovetëlëvizës me rrota, i cili është projektuar dhe ndërtuar për t'u tërhequr nga një mjet;

4. "gjysmërimorkio" nënkupton çdo rimorkio të projektuar për t'u bashkuar me një mjet motorik në mënyrë të tillë që një pjesë e tij të mbështetet në mjetin motorik dhe një pjesë e konsiderueshme e masës së tij dhe masa e ngarkesës së tij bartet nga mjeti motorik;

5. "mjet me dy ose tre rrota" nënkupton çdo mjet motorik me dy rrota, me ose pa një kosh, dhe çdo tricikël ose katërçikël;

6. "mjet i regjistruar" do të thotë një mjet i cili është i regjistruar ose i vënë në shërbim në Republikën e Shqipërisë;

7. "mjet me interes historik" nënkupton çdo mjet i cili konsiderohet historik nga legjislacioni përkatës ose nga një prej organeve të autorizuara dhe që përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:

a. është prodhuar ose regjistruar për herë të parë të paktën 30 vjet më parë;

b. lloji i tij specifik, siç përcaktohet në legjislacion, nuk është më në prodhim;

c. është mirëmbajtur dhe ruajtur historikisht në gjendjen fillestare dhe nuk ka pësuar ndryshime thelbësore në karakteristikat teknike të përbërësve kryesorë;

8. "mbajtës i certifikatës së regjistrimit" nënkupton personin juridik ose fizik në emër të të cilit është regjistruar mjeti;

9. "kontroll teknik" nënkupton një inspektim në përputhje me aneksin I, të kryer për t'u siguruar që një mjet të jetë i sigurt për t'u përdorur në rrugët publike dhe se ai është në përputhje me karakteristikat e kërkuara dhe të detyrueshme të sigurisë dhe mjedisit;

10. "miratim" nënkupton një procedurë në të cilën vërtetohet se një mjet i përshtatet dispozitave

përkatëse administrative dhe kërkesave teknike të të legjislacionit përkatës;

11. "mangësi" nënkupton defekte teknike dhe raste të tjera të mospërputhjes të gjetura gjatë një kontrolli teknik;

12. "certifikatë e kontrollit teknik" nënkupton raportin e kontrollit të mjetit të lëshuar nga autoriteti kompetent ose një qendër kontrolli që përmban rezultatin e kontrollit teknik;

13. "inspektor" nënkupton një person të autorizuar nga autoriteti i tij kompetent për të kryer kontrolle teknike në një qendër kontrolli ose, kur është e përshtatshme, në emër të një autoriteti kompetent;

14. "autoritet kompetent" nënkupton një autoritet ose organ publik i ngarkuar nga ministri përgjegjës për transportin, përgjegjës për menaxhimin e sistemit të kontrollit teknik të mjeteve, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, kryerjen e kontrolleve teknike;

15. "qendra e kontrollit" do të thotë një organ ose institucion publik ose privat i autorizuar nga ministri përgjegjës për transportin për të kryer kontrollet teknike;

16. "organ mbikëqyrës" nënkupton një organ ose organe të caktuara nga ministri përgjegjës për transportin, përgjegjës për mbikëqyrjen e qendrave të kontrollit. Një organ mbikëqyrës mund të jetë pjesë e autoritetit kompetent ose autoriteteve kompetente;

17. "ishull i vogël" nënkupton një ishull me më pak se 5 000 banorë, që nuk është i lidhur me pjesët e tjera të territorit nga ura rrugore ose tunele rrugore;

18. "zona me popullsi të paktë" nënkupton një zonë të paracaktuar me dendësi të popullsisë prej më pak se pesë persona për kilometër katror;

19. "rrugë publike" nënkupton një rrugë që është në shërbim të përgjithshëm publik, siç është rruga lokale, rajonale ose kombëtare, interurbane, autostrada.

KAPITULLI II
DETYRIME TË PËRGJITHSHME

Neni 4
Përgjegjësitë

1. Çdo mjet i regjistruar në Republikën e Shqipërisë duhet të kontrollohet në mënyrë periodike në përputhje me këtë udhëzim nga qendrat e kontrollit të autorizuara nga ministri përgjegjës për transportin.

2. Kontrollet teknike duhet të kryhen nga subjektet e licencuara nga ministri përgjegjës për transportin ose nga organet ose institucionet e përcaktuara prej tij dhe të mbikëqyrura nga ministria përgjegjëse për transportin, duke përfshirë dhe organet private të autorizuara.

3. Përgjegjësitë për mbajtjen e një automjeti në një gjendje të sigurt dhe të përshtatshme teknike janë të përcaktuara në nenin 79, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KAPITULLI III
KËRKESAT MINIMALE NË LIDHJE ME KONTROLLET TEKNIKE

Neni 5
Data dhe frekuenca e kontrollit

1. Mjetet i nënshtrohen kontrollit teknik brenda intervaleve të mëposhtme:

a) mjetet e reja të kategorisë M1 dhe N1: tre vjet pas datës në të cilën automjeti është regjistruar së pari dhe më pas çdo dy vjet;

b) mjetet e kategorisë M1 të përdorura, si: taksi, autoshkolla ose ambulanca, automjetet e kategorive M2, M3, N2, N3, O3 dhe O4: një vit pas datës në të cilën mjeti është regjistruar së pari dhe më pas çdo vit;

c) mjetet e kategorisë T5, përdorimi i të cilave kryhet kryesisht në rrugë publike për qëllime transporti komercial: tre vjet pas datës në të cilën automjeti është regjistruar së pari dhe më pas çdo dy vjet;

d) mjetet e kategorive L3, L4, L5 dhe L7, me një zhvendosje motorike prej më shumë se 125 cm^3: tre vjet pas datës në të cilën automjeti është regjistruar së pari, dhe më pas çdo dy vjet;

2. Pavarësisht nga data e kontrollit të fundit teknik të mjetit, autoriteti kompetent përkatës mund të kërkojë nga ai që t'i nënshtrohet një kontrolli teknik para datave të përmendura në paragrafin 1 në rastet e mëposhtme:

a) pas një aksidenti që ndikon në komponentët kryesorë të sigurisë së mjetit, të tilla si: rrota, suspensioni, zonat e deformimit, sistemet airbag, sistemi i drejtimit ose frenat;

b) kur sistemet dhe komponentët e sigurisë dhe të mjedisit të mjetit janë ndryshuar ose modifikuar;

c) në rastet kur siguria në rrugë është e prekur seriozisht.

Neni 6
Përmbajtja dhe metodat e testimit

1. Për kategoritë e mjeteve që janë brenda fushëveprimit të këtij udhëzimi, kontrollet teknike duhet të sigurojnë që të mbulojnë së paku zonat e përmendura në pikën 2 të aneksit I.

2. Për secilën zonë të referuar në paragrafin 1, qendrat e kontrollit duhet të kryejnë një kontroll teknik që mbulon të paktën elementet e referuara në pikën 3 të aneksit I, duke përdorur metodën e rekomanduar ose ekuivalente të miratuar nga një autoritet kompetent i zbatueshëm për kontrollin e atyre elementeve, siç përcaktohet në pikën 3 të aneksit I. Kontrolli mund të përfshijë gjithashtu një verifikim nëse pjesët dhe komponentët përkatës të mjetit i korrespondojnë karakteristikave të kërkuara të sigurisë dhe mjedisit që ishin në fuqi në kohën e miratimit ose, nëse është e përshtatshme, në kohën e modifikimit (zëvendësimeve).

3. Kontrollet duhet të kryhen duke përdorur teknikat dhe pajisjet aktualisht në dispozicion pa përdorimin e mjeteve për të çmontuar ose hequr ndonjë pjesë të mjetit.

Neni 7
Vlerësimi i mangësive

1. Për çdo element që kontrollohet, aneksi I siguron një listë minimale të mangësive të mundshme dhe shkallën e seriozitetit të tyre.

2. Mangësitë që gjenden gjatë kontrolleve periodike të mjeteve do të kategorizohen në njërën nga grupet e mëposhtme:

a) mangësi të vogla që nuk kanë efekt të rëndësishëm mbi sigurinë e mjetit ose ndikimin në mjedis, dhe mospërputhje të tjera të vogla;

b) mangësi të mëdha që mund të dëmtojnë sigurinë e automjetit ose të kenë ndikim në mjedis ose të rrezikojnë përdoruesit e tjerë të rrugës, ose mospërputhje të tjera më të rëndësishme;

c) mangësi të rrezikshme që përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë në rrugë ose që kanë ndikim në mjedis, të cilat justifikojnë që autoriteti kompetent të ndalojë përdorimin e mjetit në rrugë publike.

3. Një mjet që ka mangësi që futen në më shumë se një nga grupet e mangësive të përmendura në paragrafin 2, do të klasifikohen në grupin që korrespondon me mangësitë më serioze. Një mjet që tregon disa mangësi brenda zonës së njëjtë të inspektimit, siç është identifikuar në fushëveprimin e testit të përmendur në pikën 2 të aneksit I, mund të klasifikohet në grupin tjetër me mangësi më serioze nëse mund të demonstrohet se efekti i kombinuar i këtyre mangësive rezulton në një rrezik më të lartë për sigurinë në rrugë.

Neni 8
Certifikata e kontrollit teknik

1. Qendrat e kontrollit teknik, të cilat kanë kryer një kontroll teknik në një mjet, do të lëshojnë një certifikatë të kontrollit teknik për atë mjet që tregon të paktën elementet e standardizuara të kodeve përkatëse të harmonizuara të Bashkimit Evropian, siç përcaktohet në aneksin II.

2. Qendrat e kontrollit teknik, do të vënë certifikatën e kontrollit teknik ose, në rastin e një certifikate elektronike të kontrollit teknik, një kopje të printuar të një certifikate të tillë, në dispozicion të personit që paraqet mjetin për kontroll.

3. Pa paragjykuar nenin 5, në rast të riregjistrimit të një mjeti tashmë të regjistruar në një shtet anëtar të BE-së, qendra e kontrollit teknik duhet të njohë certifikatën e kontrollit teknik të mjetit të lëshuar nga ai shtet tjetër anëtar, sikur vetë ai të ketë lëshuar këtë certifikatë, me kusht që certifikata e kontrollit teknik të jetë akoma e vlefshme në lidhje me intervalet e frekuencave të përcaktuara për kontrollet teknike periodike nga legjislacioni shqiptar. Në rast dyshimi, autoriteti kompetent mund të verifikojë vlefshmërinë e certifikatës së kontrollit teknik përpara se ta njohë atë.

4. Pa paragjykuar nenin 5, pika 2 dhe paragrafin 3 të këtij neni, qendrat e kontrollit teknik do të njohin, në parim, vlefshmërinë e certifikatës së kontrollit teknik në rast se ndryshon pronësia e një mjeti, që ka një dëshmi të vlefshme të kontrollit teknik periodik.

5. Qendrat e kontrollit duhet të komunikojnë në mënyrë elektronike, me autoritetin kompetent, informacionin e përmendur në certifikatat e kontrollit teknik që ato lëshojnë. Ky komunikim do të bëhet brenda një kohe të arsyeshme pas lëshimit të certifikatës së kontrollit teknik. Deri në datën e

fundit, qendrat e kontrollit mund të komunikojnë informacionin përkatës tek autoriteti kompetent me çdo mjet tjetër. Periudha gjatë së cilës autoriteti kompetent duhet të ruajë atë informacion nuk duhet të jetë më pak se 36 muaj, pa paragjykuar sistemin kombëtar të taksave në Republikën e Shqipërisë.

6. Qendrat e kontrollit teknik duhet të garantojnë që, për qëllime të kontrollit të odometrit, në rastet kur një odometer është normalisht i instaluar, informacioni i përfshirë në kontrollin e mëparshëm teknik t'i vihet në dispozicion inspektorëve sapo të jetë në dispozicion në mënyrë elektronike. Në rastet kur konstatohet se ka një manipulim të odometrit me qëllim të reduktimit ose të keqparaqitjes së distancës së kryer të regjistruar të një mjeti, një manipulim i tillë ndëshkohet administrativisht sipas përcaktimeve të nenit 72 të Kodit Rrugor.

7. Qendrat e kontrollit teknik duhet të garantojnë që rezultatet e kontrollit teknik të njoftohen ose të vihen në dispozicion në mënyrë elektronike, sa më shpejt që të jetë e mundur, tek autoriteti përgjegjës për regjistrimin e mjetit. Ky njoftim duhet të përmbajë informacionin e përmendur në certifikatën e kontrollit teknik.

Neni 9
Ndjekja e mangësive

1. Në rastin e mangësive të vogla, kontrolli do të konsiderohet se është kaluar, mangësitë duhet të korrigjohen dhe mjeti nuk duhet të rikontrollohet.

2. Në rastin e mangësive të mëdha, testi do të konsiderohet i pakaluar. Kontrolli i mëpasshëm zhvillohet jo më vonë se një muaj pas kontrollit fillestar.

3. Në rastin e mangësive të rrezikshme, testi do të konsiderohet i pa kaluar. Mjeti në fjalë të mos përdoret në rrugë publike dhe certifikata e kontrollit teknik (raporti teknik) të theksojë për mospërdorimin e tij në trafikun rrugor për një periudhë të kufizuar kohore pa kërkuar një proces të ri regjistrimi, deri në kohën kur mangësitë të jenë korrigjuar dhe të lëshohet një certifikatë e re e kontrollit teknik të mjetit që dëshmon se mjeti është në gjendje të përshtatshme teknike, jo më vonë se 30 ditë pas kontrollit fillestar.

Neni 10
Dëshmia e kontrollit

1. Qendra e kontrollit që ka kryer një kontroll teknik në një mjet të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të ofrojë një provë, si një tregues në dokumentin e regjistrimit të automjetit, një pullë, një certifikatë ose ndonjë informacion tjetër lehtësisht të aksesueshëm, për çdo mjet që ka kaluar një kontroll të tillë. Prova duhet të tregojë datën në të cilën do të kryhet kontrolli i ardhshëm teknik.

2. Kur mjeti i kontrolluar i përket një kategorie automjetesh që nuk është subjekt i regjistrimit në Republikën e Shqipërisë, prova e kontrollit të shfaqet në mënyrë të dukshme në atë mjet.

3. Për qëllime të qarkullimit të lirë, çdo qendër kontrolli ose autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të njohë provën e ofruar nga një qendër kontrolli ose autoriteti kompetent i një shteti anëtar të BE-së në përputhje me paragrafin 1.

KAPITULLI IV
DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Neni 11
Objektet dhe pajisjet e kontrollit

1. Në qendrat e kontrollit teknik, objektet dhe pajisjet e kontrollit të përdorura për kryerjen e kontrolleve teknike duhet të përputhen me kërkesat minimale teknike të përcaktuara në aneksin III.

2. Në qendrat e kontrollit teknik, objektet dhe pajisjet e kontrollit të përdorura për kryerjen e kontrolleve teknike duhet të jene dhe mbahen në përputhje me specifikimet e dhëna nga prodhuesit.

3. Pajisjet e përdorura për matjet duhet të kalibrohen në mënyrë periodike në përputhje me aneksin III dhe të verifikohen në përputhje me specifikimet e dhëna nga prodhuesi i pajisjes.

Neni 12
Qendrat e kontrollit

1. Qendrat e kontrollit në të cilat inspektorët kryejnë kontrolle teknike duhet të autorizohen nga ministri përgjegjës për transportin.

2. Për të përmbushur kërkesat minimale në drejtim të menaxhimit të cilësisë, qendrat e kontrollit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në këtë udhëzim.

3. Qendrat e kontrollit duhet të garantojnë objektivitetin dhe cilësinë e lartë të kontrolleve teknike.

Neni 13
Inspektorët

1. Kontrollet teknike kryhen nga inspektorët që përmbushin kërkesat minimale të kompetencës dhe trajnimit të përcaktuara në aneksin IV.

2. Autoritetet kompetente ose qendrat e trajnimit të miratuara duhet të sigurojnë një certifikatë për inspektorët që përmbushin kërkesat minimale të kompetencës dhe trajnimit. Kjo certifikatë duhet të përfshijë së paku informacionin e përmendur në pikën 3 të aneksit IV.

3. Inspektorët aktualë të punësuar në një qendër kontrolli të licencuar ose e autorizuar nga autoriteti kompetent, përjashtohen nga kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të aneksit IV.

4. Gjatë kryerjes së një kontrolli teknik, inspektori duhet të jetë i lirë nga çdo konflikt interesi në mënyrë që të sigurojë, të ruhet një nivel i lartë i paanshmërisë dhe objektivitetit.

5. Personi që paraqet mjetin për kontroll teknik duhet të informohet për çdo mangësi të identifikuar në mjetin që duhet të korrigjohet.

6. Rezultatet e një kontrolli teknik mund të modifikohen, kur është e përshtatshme, nga organi mbikëqyrës, ose në përputhje me procedurën e ngritur nga autoriteti kompetent, nëse gjetjet e kontrollit teknik janë qartësisht të pasakta.

Neni 14
Mbikëqyrja e qendrave të kontrollit

1. Qendrat e kontrollit teknik duhet të mbikëqyren.

2. Organi mbikëqyrës kryen të paktën detyrat e parashikuara në pikën 1 të aneksit V dhe plotëson kërkesat e parashtruara në pikat 2 dhe 3 të atij aneksi.

3. Ministria do të vërë në dispozicion të publikut rregullat dhe procedurat që mbulojnë organizimin, detyrat dhe kërkesat, duke përfshirë kërkesat e pavarësisë të zbatueshme për personelin e një organi mbikëqyrës.

4. Qendrat e kontrollit të drejtuara drejtpërdrejt nga një autoritet kompetent përjashtohen nga kërkesat për autorizimin dhe mbikëqyrjen kur organi mbikëqyrës është pjesë e autoritetit kompetent.

5. Kërkesat e përmendura në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni mund të konsiderohen të plotësuara nga autoriteti kompetent, në se qendrat e kontrollit janë të akredituara sipas legjislacionit përkatës për akreditimin.

KAPITULLI V
BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 15
Bashkëpunimi administrativ me shtetet anëtare të BE-së

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është një pikë kombëtare kontakti përgjegjëse për shkëmbimin e informacionit me shtetet anëtare të BE-së dhe Komisionin të BE-së në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do t'i përcjellë Komisionit të BE-së emrat dhe detajet e tjera të pikave të tyre kombëtare të kontaktit dhe do ta informojnë atë pa vonesë për çdo ndryshim të tyre.

KAPITULLI VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Ndëshkimet

Neni 79, i ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodit Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton ndëshkimet, për cilindo që qarkullon me një mjet të cilit nuk i është kryer kontrolli teknik, për mosparaqitje brenda afateve të çdo kategorie mjetesh në qendrat e kontrollit teknik me mbi 10 ditë, qarkullimin e mjetit me të meta teknike etj.

Neni 17
Dispozitat kalimtare

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin për një periudhë prej jo më shumë se 30.6.2022, të objekteve dhe pajisjeve të kontrollit të referuara në nenin 11 që nuk përputhen me kërkesat minimale të përcaktuara në aneksin III për kryerjen e kontrolleve teknike.

2. Kërkesat e parashtruara në aneksin V zbatohen më së largu deri më 1.1.2023.

Neni 18
Shfuqizimi

1. Udhëzimi nr. 2, datë 11.3.2010, "Për kontrollin teknik të mjeteve rrugore", sipas direktivës 2009/40/KE, shfuqizohet me fuqi nga 1.1.2022.

Neni 19
Hyrja në fuqi

1. Për monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi, ngarkohet Sektori i Sigurisë Rrugore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKSI I
KËRKESAT MINIMALE NË LIDHJE ME PËRMBAJTJEN DHE METODAT E REKOMANDUARA TË KONTROLLIT TEKNIK

I. TË PËRGJITHSHME

Ky aneks identifikon sistemet dhe komponentët e mjeteve për t'u kontrolluar; ai detajon metodat e rekomanduara për kontrollin e tyre dhe kriteret që duhet të përdoren gjatë përcaktimit nëse gjendja e mjetit është e pranueshme.

Kontrolli teknik duhet të mbulojë të paktën artikujt e shënuar në pikën 3 më poshtë me kusht që këto të lidhen me pajisjet e mjetit që kontrollohet. Kontrolli teknik mund të përfshijë gjithashtu një verifikim nëse pjesët dhe komponentët përkatës të atij mjeti korrespondojnë me karakteristikat e kërkuara të sigurisë dhe mjedisit që ishin në fuqi në kohën e miratimit ose, nëse është e aplikueshme, në kohën e modifikimit (zëvendësimeve).

Kur projektimi i mjetit nuk lejon aplikimin e metodave të kontrollit të përcaktuara në këtë aneks, kontrolli teknik duhet të kryhet në përputhje me metodat e rekomanduara të kontrollit teknik të pranuara nga autoritetet kompetente. Autoriteti kompetent duhet të kërkojë që standardet e sigurisë dhe mjedisit të ruhen.

Kontrolli teknik i të gjitha elementeve të listuara më poshtë do të konsiderohet si i detyrueshëm në kontekstin e një kontrolli teknik periodik të mjetit, me përjashtim të atyre të shënuara me shenjën "X", të cilat janë të lidhura me gjendjen e mjetit dhe përshtatshmërisë së tij për përdorim në rrugë por të cilat nuk konsiderohen thelbësore në kontekstin e një kontrolli teknik.

"Arsyet për dështim" nuk zbatohen në rastet kur ato i referohen kërkesave që nuk janë përshkruar në legjislacionin përkatës për miratimin e mjeteve në kohën e regjistrimit të parë ose hyrjes së parë në shërbim ose në kërkesat e modifikimeve.

Kur një metodë kontrolli tregohet si vizuale, do të thotë që, përveç shqyrtimit të elementeve në fjalë, inspektori gjithashtu, nëse është e përshtatshme, do t'i trajtojë ato, të vlerësojë zhurmën e tyre ose të përdorë ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm të inspektimit që nuk përfshin përdorimin e pajisjeve.

II. FUSHAT E KONTROLLIT TEKNIK

Kontrolli teknik duhet të mbulojë të paktën fushat e mëposhtme:

0. Identifikimi i mjetit;
1. Pajisjet e frenimit;
2. Sistemin e drejtimit;
3. Shikueshmërinë;
4. Pajisjet e ndriçimit dhe pjesët e sistemit elektrik;
5. Boshtet, rrotat, gomat, suspensionin;
6. Shasinë dhe shtesat e shasisë;
7. Pajisje të tjera;
8. Ndikimin në mjedis;
9. Kontrolle shtesë për mjetet e kategorive M2 dhe M3 që mbajnë pasagjerë.

III. PËRMBAJTJA DHE METODAT E KONTROLLIT TEKNIK, VLERËSIMI I MANGËSIVE TË MJETEVE

Kontrolli teknik duhet të mbulojë të paktën elementet dhe të përdorë standardet minimale dhe metodat e rekomanduara, të renditura në tabelën në vijim.

Për secilin sistem dhe komponent të mjetit që i nënshtrohet kontrollit teknik, vlerësimi i mangësive duhet të kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në atë tabelë, rast pas rasti.

Mangësitë që nuk janë të listuara në këtë aneks do të vlerësohen në lidhje me rreziqet që ato i paraqesin sigurisë rrugore.

ELEMENTI	METODA	ARSYET PËR DËSHTIM	VLERËSIMI I MANGËSIVE		
			e vogël	e madhe	e rrezikshme
0. IDENTIFIKIMI I AUTOMJETIT					
0.1. Targat e regjistrimit (nëse kërkohen sipas kërkesës[1])	Inspektimi vizual	a) Targat mungojnë ose janë të vendosura në mënyrë të pasigurt sa mund të bien.		**X**	
		b) Mbishkrimi mungon ose është i palexueshëm.		**X**	
		c) Jo në përputhje me dokumentet e mjetit ose regjistrat.		**X**	
0.2. Numri i identifikimit të mjetit / numri i shasisë / numri serial	Inspektimi vizual	a) Mungon ose nuk mund të gjendet.		**X**	
		b) Jo i plotë, i palexueshëm, dukshëm i falsifikuar ose nuk përputhet me dokumentet e mjetit.		**X**	
		c) Dokumentet e mjetit të palexueshme ose gabime drejtshkrimi.		**X**	
1. SISTEMI I FRENIMIT					
1.1. Gjendja mekanike dhe funksionimi					
1.1.1. Pedali i frenit / freni i dorës	Inspektim vizual i elementeve gjatë vënies në funksion të sistemit të frenimit. **Shënim.** *Mjetet me sistem frenimi hidraulik duhet të inspektohen me motor të fikur.*	a) Pedali shtypet me vështirësi.		**X**	
		b) Konsumim i tepërt.		**X**	
1.1.2. Gjendja e pedalit / frenit të dorës dhe lëvizja për aktivizimin e frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë vënies në funksion të sistemit të frenimit. **Shënim.** *Mjetet me sistem frenimi hidraulik duhet të inspektohen me motor të fikur.*	a) Lëvizje e tepërt ose e pamjaftueshme.		**X**	
		b) Pedali nuk kthehet prapa në mënyre korrekte. - Nëse funksionaliteti është reduktuar.	**X**	**X**	
		c) Pajisja antirrëshqitje në pedalin e frenave mungon, është e lirshme, ose e konsumuar.		**X**	
ELEMENTI	**METODA**	**ARSYET PËR DËSHTIM**	**VLERËSIMI I MANGËSIVE**		
			e vogël	e madhe	e rrezikshme
1.1.3. Rregullatori i ajrit të frenave	Inspektim vizual i elementeve në presion normal pune. Kontroll i kohës së nevojshme për vakumin ose presionin e ajrit të arrijë vlerën e sigurt të punës si dhe kontroll i funksionimit të pajisjes paralajmëruese, valvulës siguruese për lëshimin e lehtë.	a) Presion/vakum i pamjaftueshëm për të asistuar të paktën katër frenime pas aktivizimit të sinjalit paralajmërues (ose treguesi i matësit gjendet në një zonë të pasigurt). - Të paktën dy frenime pas aktivizimit të sinjalit paralajmërues (ose treguesi i matësit gjendet në një zonë të pasigurt).		**X**	**X**

		b) Koha e nevojshme për të arritur vlera të sigurta pune të presionit ajrit në vakum është shumë e gjatë sipas kërkesës [1].		X	
		c) Valvule siguruese nuk funksionon.		X	
		d) Rrjedhje ajri që shkakton një ulje të dukshme të presionit ose rrjedhje të dëgjueshme ajri.		X	
		e) Dëmtimet e jashtme kanë gjasa të ndikojnë në funksionimin e sistemit të frenimit. - Performanca e duhur e frenit ndihmës nuk është arritur.		X	X
1.1.4. Indikatori i presionit të ulët	Kontroll funksional	- Keqfunksionim ose indikatori me defekt. - Presioni i ulët nuk mund të matet.	X	X	
1.1.5. Valvola e frenit të dorës	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit.	a) Pajisja e kontrollit e thyer, e dëmtuar ose tepër e konsumuar.		X	
		b) Pajisja e kontrollit në valvolë e pasigurt ose valvola e pasigurt.		X	
		c) Lidhjet të lirshme ose rrjedhje në sistem.		X	
		d) Funksionim i pakënaqshëm.		X	
1.1.6. Aktivizuesi i frenit parkimit, leva për aktivizim, mekanizmi bllokues i frenit parkimit, freni elektronik i parkimit	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit.	a) Mekanizmi bllokues nuk funksionon në mënyrë korrekte.		X	
		b) Konsumim i boshtit ose mekanizmit bllokues. - Konsumim i tepërt.	X	X	
		c) Lëvizje e tepërt e levës që tregon rregullim jokorrekt.		X	
		d) Aktivizuesi mungon, i dëmtuar ose jofunksional.		X	
		e) Funksionim jokorrekt, indikatori paralajmërues tregon keqfunksionim.		X	
ELEMENTI	**METODA**	**ARSYET PËR DËSHTIM**	**VLERËSIMI I MANGËSIVE**		
			E vogël	E madhe	E rrezikshme
1.1.7. Valvolat e frenimit (valvolat e këmbës, rregullatori i ajrit, valvola rregulluese)	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit.	a) Dëmtim i valvulit ose rrjedhje e tepërt ajri. - Nëse funksionaliteti është reduktuar.		X	X
		b) Rrjedhje e tepërt vaji nga kompresori.	X		
		c) Valvola e pasigurt ose e montuar jo në mënyrën e duhur.		X	
		d) Rrjedhje e lëngut hidraulik. - Nëse funksionaliteti është reduktuar.		X	X
1.1.8. Lidhëset e frenave për rimorkiot (elektrike & pneumatike)	Shkëput dhe rilidh lidhëset e sistemit të frenave të mjetit tërheqës dhe rimorkios.	a) Kapaku ose valvola automatike me defekt. - Nëse funksionaliteti është reduktuar.	X	X	
		b) Kapaku ose valvola të pasigurt ose të montuar jo në mënyrën e duhur. - Nëse funksionaliteti është reduktuar.	X	X	

		c) Rrjedhje e tepërt. - Nëse funksionaliteti është reduktuar.		**X**	**X**
		d) Funksionim jokorrekt. - Ndikon në funksionimin e frenave.		**X**	**X**
1.1.9. Ena e presionit për ruajtjen e energjisë	Inspektim vizual.	a) Pak e dëmtuar ose pak e gërryer. - Shumë e dëmtuar, shumë e gërryer dhe ka rrjedhje.	**X**	**X**	
		b) Funksionimi i rregullatorit për derdhjen e kondensimit i reduktuar. - Rregullatori për derdhjen e kondensimit nuk funksionon.	**X**	**X**	
		c) E pasigurt ose e montuar jo në mënyrën e duhur.		**X**	
1.1.10. Përforcuesi i forcës së frenimit (servo), cilindri kryesor (sistemet hidraulike)	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.	a) Servo përforcuesi me defekt ose joefektiv. - Nëse nuk funksionon.		**X**	**X**
		b) Cilindri kryesor me defekt ndërsa frenat ende funksionojnë. - Cilindri kryesor me defekt ose me rrjedhje.		**X**	**X**
		c) Cilindri kryesor i pasigurt ndërsa frenat ende funksionojnë. - Cilindri kryesor i pasigurt.		**X**	**X**
		d) Lëng i pamjaftueshëm frenash nën shenjën MIN. - Lëngu i frenave shumë poshtë shenjës MIN. - Lëngu i frenave i pa dukshëm.	**X**	**X**	**X**
		e) Kapaku i rezervuarit të cilindrit kryesor mungon.	**X**		
		f) Drita paralajmëruese e lëngut të frenave e ndezur ose me defekt.	**X**		
		g) Funksionim jokorrekt i pajisjes paralajmëruese të nivelit të lëngut të frenave.	**X**		
1.1.11. Tubat e ngurtë të frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.	a) Rrezik i pashmangshëm për prishje apo thyerje.			**X**
		b) Tubat ose lidhjet rrjedhin (sistemi pneumatik i frenave). - Tubat ose lidhjet rrjedhin (sistemi hidraulik i frenave).		**X**	**X**
		c) Tubat të dëmtuar ose tepër të gërryer. - Ndikojnë në funksionimin e frenave lidhur me bllokimin apo rrezikun nga rrjedhja e menjëhershme.		**X**	**X**
		d) Tubat të vendosur në mënyrë të gabuar. - Rrezik për dëmtim.	**X**	**X**	
1.1.12. Tubat elastik të frenave	Inspektim vizual i elementeve	a) Rrezik i pashmangshëm për prishje ose thyerje.			**X**

	gjatë funksionimit të sistemit të frenimit„ nëse është e mundur.	b) Tubat të dëmtuar, me pika fërkimi, të përdredhur ose shumë të shkurtër. - Tubat të dëmtuar ose me pika fërkimi.	**X**	**X**	
		c) Tubat apo lidhjet rrjedhin (sistemi pneumatik i frenimit). - Tubat apo lidhjet rrjedhin (sistemi hidraulik i frenimit).		**X**	**X**
		d) Tubat të fryrë nën presion. - Kabllo i dëmtuar.		**X**	**X**
		e) Tubat janë poroz.		**X**	
1.1.13. Tamburet dhe ferrotat	Inspektim vizual.	a) Tamburet apo ferrotat tepër të konsumuara (arritje te shenja minimale). - Tamburet apo ferrotat tepër të konsumuara (shenja minimale jo e dukshme).		**X**	**X**
		b) Tamburet apo ferrotat të përlyera (vajra, graso, etj.). - Performanca e frenave e reduktuar.		**X**	**X**
		c) Tamburet apo ferrotat mungojnë ose janë të montuar në mënyrë të gabuar.			**X**
ELEMENTI	**METODA**	**ARSYET PËR DËSHTIM**	**VLERËSIMI I MANGËSIVE**		
			E vogël	E madhe	E rrezikshme
1.1.14. Tamburet e frenave, disqet e frenave	Inspektim vizual.	a) Tamburi apo disku të konsumuar. - Tamburi apo disku tepër të konsumuar, tepër të gërvishtur, të krisur, të pasigurt apo të thyer.		**X**	**X**
		b) Tamburi apo disku të kontaminuar (vajra, graso etj.). - Performanca e frenave e reduktuar.		**X**	**X**
		c) Tamburi apo disku mungojnë.			**X**
		d) Mbrojtësi i frenave në pjesën e pasme i montuar në mënyrë të pasigurt.		**X**	
1.1.15. Kabllot e frenave, shufrat, levat, lidhjet	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit„ nëse është e mundur.	a) Kabllot të dëmtuara ose të ngatërruara. - Performanca e frenimit e reduktuar.		**X**	**X**
		b) Pjesët tepër të konsumuara ose të gërryera. - Performanca e frenimit e reduktuar.		**X**	**X**
		c) Kablli, leva ose nyja të pasigurt.		**X**	
		d) Mbajtësit e kabllove të dëmtuar.		**X**	
		e) Kufizim i lëvizjes së lire të sistemit të frenave.		**X**	
		f) Lëvizje e pazakontë e levës / lidhjes që tregon vendosje të gabuar ose konsumim të tepërt.		**X**	
1.1.16. Cilindri i frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të	a) Cilindri i krisur ose i dëmtuar. - Performanca e frenimit e reduktuar.		**X**	**X**

	frenimit, nëse është e mundur.	b) Cilindri rrjedh. - Performanca e frenimit e reduktuar.		X	X
		c) Cilindri i montuar në mënyrë të pasigurt ose të papërshtatshme. - Performanca e frenimit e reduktuar.		X	X
		d) Cilindri tepër i gërryer. - Mund të kriset.		X	X
		e) Lëvizje e pamjaftueshme ose e tepërt e pistonit punues apo membranës. - Performanca e frenimit e reduktuar (mungesë e lëvizjes rezervë).		X	X
		f) Mansheta mbrojtëse e dëmtuar. - Mansheta mbrojtëse mungon ose tepër e dëmtuar.	X	X	
1.1.17. Rregullatori i forcës së frenimit	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur.	a) Lidhja me defekt		X	
		b) Lidhje e përshtatur në mënyrë jokorrekte.		X	
		c) Valvola e bllokuar ose nuk funksionon (funksionimi ABS). - Valvola e bllokuar ose nuk funksionon.		X	X
		d) Valvola mungon (nëse kërkohet).			X
		e) Pllaka e të dhënave mungon.	X		
		f) Të dhënat janë të palexueshme ose jo në përputhje me kërkesën [1].	X		
1.1.18. Kompensimi automatik dhe indikatori i konsumit të frenave	Inspektim vizual.	a) Pajisja për kompensim automatik të konsumit të frenave e dëmtuar, e bllokuar ose me lëvizje jonormale, konsumim të tepërt ose e vendosur në pozicion jokorrekt.		X	
		b) Pajisja për kompensim automatik të konsumit të frenave është me defekt.		X	
		c) E instaluar ose e zëvendësuar në mënyrë jokorrekte.		X	
1.1.19. Sistemi i frenimit me ngadalësim afatgjatë (nëse automjeti është i pajisur ose nëse e detyrueshme)	Inspektim vizual.	a) Lidhjet ose pajisjet të pasigurta. - Nëse funksionaliteti është i reduktuar.	X	X	
		b) Sistemi dukshëm me defekt ose mungon.		X	
1.1.20. Funksionimi automatik i frenave të rimorkios	Shkëput lidhësen e sistemit të frenave ndërmjet mjetit tërheqës dhe rimorkios.	- Frenat e rimorkios nuk aktivizohen automatikisht kur lidhësja është e shkëputur.			X

1.1.21. Sistemi i frenimit në tërësi	Inspektim vizual	a) Pajisjet e tjera të sistemit (p.sh. pompa kundra ngrirjes, tharësi i ajrit) të dëmtuar nga ana e jashtme ose tepër të gërryer në mënyrë të tillë sa që ndikojnë negativisht në sistemin e frenimit. - Performanca e frenave e reduktuar.		**X**	**X**
		b) Rrjedhje ajri ose e lëndës kundra ngrirjes. - Funksionaliteti i sistemit i reduktuar.	**X**	**X**	
		c) Komponentët të montuar në mënyrë të pasigurt ose jokorrekte.		**X**	
		d) Modifikim i pasigurt i komponentëve[3]. - Performanca e frenave e reduktuar.		**X**	**X**
1.1.22. Lidhjet për kontrollin (nëse janë të instaluar ose të detyrueshëm)	Inspektim vizual.	a) Mungojnë.		**X**	
		b) Të dëmtuar. - Të papërdorshëm ose me rrjedhje.	**X**	**X**	
1.1.23. Sistemi i frenimit me inerci	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	- Efikasitet e pamjaftueshëm.		**X**	
1.2. Efektiviteti dhe performanca e shërbimit të frenit					
1.2.1. Performanca	Gjatë një kontrolli mbi një bankoprovë frenash, ose nëse kjo është e pamundur, gjatë një kontrolli në rrugë, aktivizo frenat në mënyrë progresive deri në forcën maksimale të frenimit.	a) Forcë e pamjaftueshme frenimi në një ose më shumë rrota. - Asnjë forcë frenimi në një ose më shumë rrota.		**X**	**X**
		b) Forca e frenimit në rrotë është më pak se 70 % e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks. Ose, në rastin e kontrollit në rrugë, automjeti devijon shumë nga drejtimi i lëvizjes. - Forca e frenimit në rrotë është më pak se 50 % e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks në rastin e akseve drejtues.		**X**	**X**
		c) Forca e frenimit nuk ndryshon gradualisht (bllokim).		**X**	
		d) Aktivizim i vonuar i frenave në cilëndo rrotë.		**X**	
		e) Luhatje e tepërt e forcës së frenimit gjatë rrotullimit të plotë të një rrote.		**X**	
1.2.2. Efektiviteti	Kontroll në një bankoprovë frenash, ose, nëse kjo nuk mund të përdoret për arsye sigurie, kontroll në rrugë duke përdorur një instrument regjistrues të ngadalësimit për të përcaktuar	Nuk arrihen standardet minimale si më poshtë ([1]): 1. Mjetet e regjistruara për herë të parë pas datës 1.1.2012: - kategoria M1: 58 % - kategoritë M2 dhe M3: 50 % - kategoria N1: 50 % - kategoritë N2 dhe N3: 50 %		**X**	

	koeficientin e frenimit në lidhje me masën maksimale të lejuar, ose, në rastin e gjysmërimorkiove, në lidhje me shumën e lejuar të ngarkesës për çdo aks. Mjetet ose rimorkiot me një masë maksimale të lejueshme që kalon 3,5 ton duhet të kontrollohen sipas standardeve ISO 21069 ose metodave ekuivalente. Kontrollet në rrugë duhet të zhvillohen në rrugë të sheshta, të drejta dhe të thata.	- kategoria O_2, O_3 dhe O4: - për gjysmërimorkiot: 45 % (2) - për rimorkiot: 50 %			
		2. Mjetet e regjistruara për herë të parë përpara datës 1.1.2012: - kategoritë M1, M2 dhe M3: 50 % (3) - kategoria N1: 45 % - kategoritë N2 dhe N3: 43 % (4) - kategoritë O2, O3 dhe O4: 40 % (5)		**X**	
		3. Kategoritë e tjera Kategoritë L (të dyja frenat së bashkë): - kategoria L1: 42 % - kategoritë L2, L6: 40 % - kategoria L3: 50 % - kategoria L4: 46 % - kategoritë L5, L7: 44 % Kategoria L (frenat në rrotën e prapme): të gjitha kategoritë: 25 % e masës totale të automjetit. Të arritura më pak se 50% e vlerave të mësipërme.		**X**	**X**
1.3. Performanca dhe efektiviteti i frenit ndihmës (të emergjencës) (nëse ka një sistem të veçantë)					
1.3.1. Performanca	Nëse sistemi i frenit ndihmës është i ndarë nga sistemi i shërbimit të frenave, përdor metodën e specifikuar në 1.2.1.	a) Forcë frenimi e pamjaftueshme në një ose më shumë rrota. - Asnjë forcë frenimi në një ose më shumë rrota.		**X**	**X**
		b) Forca e frenimit në cilëndo rrotë është më pak se 70 % e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks. Ose, në rastet e kontrollit në rrugë, automjeti devijon shumë nga drejtimi i lëvizjes. - Forca frenimit në cilëndo rrotë është më pak se 50 % e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks, në rast se është aks drejtues.		**X**	**X**
		c) Forca e frenimit nuk ndryshon gradualisht (bllokim).		**X**	
1.3.2. Efektiviteti	Nëse sistemi i frenit ndihmës është i ndarë nga sistemi i frenave të shërbimit, përdor metodën e specifikuar në 1.2.2.	- Forca e frenimit është më pak se 50 % (6) e performancës së frenave të shërbimit përcaktuar në seksionin 1.2.2 në lidhje me masën maksimale të lejuar. - Të arritura më pak se 50 % e vlerave të mësipërme të forcës së frenimit.		**X**	**X**
1.4. Performanca dhe efektiviteti i frenit të dorës					
1.4.1. Performanca	Aktivizo frenat gjatë një kontrolli në një bankoprovë frenash.	- Freni nuk funksionon në njërën anë, ose në rastin e kontrollit në rrugë, automjeti devijon shumë nga drejtimi i lëvizjes. - Të arritura më pak se 50 % e vlerave të forcës së frenimit, referuar në pikën 1.4.2, në lidhje me masën e mjetit gjatë kontrollit.		**X**	**X**
1.4.2. Efektiviteti	Kontroll në një bankoprovë frenash. Nëse kjo nuk është e	- Nuk jep, për të gjitha mjetet, një koeficient frenimi të paktën 16 % në lidhje me masën maksimale të lejuar, ose, për mjetet motorike, të paktën 12 % në lidhje me		**X**	

	mundur, atëherë në një kontroll në rrugë duke përdorur një indikator ose decelerometër ose me automjetin në një rrugë me pjerrësi të caktuar.	masën maksimale të kombinuar të lejuar të mjetit, cilido të jetë më i larti. - Të arritura më pak se 50 % e vlerave të mësipërme të forcës së frenimit.			**X**
1.5. Performanca e Sistemit të frenimit me ngadalësim afatgjatë	Inspektim vizual, dhe ku është e mundur, kontroll për të verifikuar funksionimin e sistemit.	a) Jo ndryshim gradual në eficiencë (nuk aplikohet për sistemet e frenimit të shkarkimit).		**X**	
		b) Sistemi nuk funksionon.		**X**	
1.6. Sistemi i frenimit antibllokazh (ABS)	Inspektim vizual dhe inspektim i pajisjes paralajmëruese dhe / ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të mjetit.	a) Pajisja paralajmëruese keqfunksionon.		**X**	
		b) Pajisja paralajmëruese tregon keqfunksionim të sistemit.		**X**	
		c) Sensorët e shpejtësisë së rrotës mungojnë ose janë të dëmtuar.		**X**	
		d) Kabllot të dëmtuar.		**X**	
		e) Komponentët e tjerë mungojnë ose janë të dëmtuar.		**X**	
		f) Sistemi tregon dështim nëpërmjet ndërfaqes elektronike të automjetit.		**X**	
ELEMENTI	**METODA**	**ARSYET PËR DËSHTIM**	**VLERËSIMI I MANGËSIVE**		
			E vogël	E madhe	E rrezikshme
1.7. Sistemi i frenimit elektronik (EBS)	Inspektim vizual dhe inspektim i pajisjes paralajmëruese dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	a) Pajisja paralajmëruese keqfunksionon.		**X**	
		b. Pajisja paralajmëruese tregon keqfunksionim të sistemit.		**X**	
		c. Sistemi tregon dështim nëpërmjet ndërfaqes elektronike të automjetit.		**X**	
1.8. Lëngu i frenave	Inspektim vizual.	- Lëngu i frenave i kontaminuar ose me sedimente. - Rrezik mosfunksionimi.		**X**	**X**
2. SISTEMI I DREJTIMIT					
2.1. Gjendja mekanike					
2.1.1. Gjendja e mekanizmit të drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me rrotat lart ose mbi pllaka rrotulluese, rrotullo timonin nga një ekstremitet në tjetrin. Inspektim vizual i funksionimit të mekanizmit të drejtimit.	a. Vështirësi në funksionimin e mekanizmit të drejtimit.		**X**	
		b. Boshti dalës i kutisë drejtuese është përdredhur ose dhëmbëzorët të konsumuar. - Funksionaliteti i reduktuar.		**X**	**X**
		c. Konsumim i tepërt i boshtit dalës të kutisë drejtuese. - Funksionaliteti i reduktuar.		**X**	**X**
		d. Lëvizje e tepërt e boshtit dalës së kutisë drejtuese. - Funksionaliteti i reduktuar.		**X**	**X**
		e. Rrjedhje. - Formim pikash.		**X** **X**	

2.1.2. Fiksimi i kutisë së mekanizmit të drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me peshën e rrotave në tokë, rrotullo timonin në sens orar dhe antiorar ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhiokon e rrotave. Inspektim vizual i fiksimit të kutisë së mekanizmit të drejtimit në shasi.	a. Kutia e fiksuar jo në mënyrën e duhur. - Fiksimet rrezikshëm të lirshme ose lëvizje relative në raport me shasinë/ karrocerinë.		X	X
		b. Vrimat fiksuese në shasi të zmadhuara. - Fiksimet të dëmtuara.		X	X
		c. Bulonat fiksues mungojnë ose të thyer. - Fiksimet të dëmtuara.		X	X
		d. Kutia e dëmtuar. - Ndikim në stabilitet ose në fiksimin e kutisë.		X	X
2.1.3. Gjendja e lidhjeve në sistemin e drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me rrotat në tokë, lëviz timonin në sens orar dhe antiorar ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhiokon e rrotave. Inspektim vizual i komponentëve të sistemit të drejtimit në lidhje me konsumimin, dëmtimet dhe sigurinë.	a. Lëvizje relative ndërmjet komponentëve e cila duhet të rregullohet. - Lëvizje e tepërt ose mundësi për t'u shkëputur.		X	X
		b. Konsumim i tepërt i nyjave. - Rrezik shumë serioz për t'u shkëputur.		X	X
		c. Thyerje ose deformime të komponentëve. - Ndikim në funksionalitet.		X	X
		d. Mungesë e pajisjeve bllokuese.		X	
		e. Lidhje e komponentëve në mënyrë jo të rregullt (p.sh. levat tërthore ose gjatësore).		X	
		f. Modifikim (zëvendësim) i pasigurt [3]. - Ndikim në funksionalitet.		X	X
		g. Mansheta mbrojtëse e dëmtuar ose në gjendje të përkeqësuar. - Mansheta mbrojtëse e mungon ose në gjendje tepër të përkeqësuar.	X	X	
2.1.4. Funksionimi i lidhjeve në sistemin e drejtimit	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe me rrotat në tokë, lëviz timonin në sens orar dhe antiorar ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhiokon e rrotave. Inspektim vizual i komponentëve të sistemit të drejtimit në lidhje me konsumimin, dëmtimet dhe sigurinë.	a. Lidhjet prekin pjesë të palëvizshme të shasisë.		X	
		b. Kufizuesit për kthimin e rrotave nuk funksionojnë ose mungojnë.		X	
2.1.5. Sistemi ndihmës i drejtimit	Kontrollo sistemin e drejtimit për rrjedhje dhe nivelin e lëngut hidraulik në depozitë (nëse është	a. Rrjedhje lëngu ose funksionaliteti i reduktuar.		X	
		b. Lëng i pamjaftueshëm (nën shenjën MIN). - Rezervuar i pamjaftueshëm.	X	X	

	i dukshëm). Me rrotat në tokë dhe me motorin e ndezur, kontrollo nëse servo përforcuesi funksionon.	c. Mekanizmi nuk funksionon. - Ndikim në sistemin e drejtimit.		**X**	**X**
		d. Mekanizmi i thyer ose i pasigurt. - Ndikim në sistemin e drejtimit.		**X**	**X**
		e. Pozicion jo i rregullt ose fërkim ndërmjet komponentëve. - Ndikim në sistemin e drejtimit.		**X**	**X**
		f. Modifikim (zëvendësim) i pasigurt[3]. - Ndikim në sistemin e drejtimit.		**X**	**X**
		g. Kabllot / tubat të dëmtuar, tepër të gërryer. - Ndikim në sistemin e drejtimit.		**X**	**X**
2.2. Timoni / shufra e timonit					
2.2.1. Gjendja e timonit / gjendja e shiritit dorezës	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe peshën e mjetit në tokë, shtyje dhe tërhiqe timonin në drejtim të shtyllës, shtyje timonin në drejtime të ndryshme në kënd të drejtë me shtyllën / nofullën. Inspektim vizual i xhiokove dhe gjendjes së lidhjeve fleksible ose nyjave universale.	a. Lëvizje relative ndërmjet timonit dhe shtyllës që tregon lidhje të lirshme. - Rrezik serioz për t'u shkëputur.		**X**	**X**
		b. Mungesë e mekanizmit lidhës me timonin. - Rrezik serioz për t'u shkëputur.		**X**	**X**
		c. Timoni, rrethi i timonit ose krahët lidhës të thyer ose të lirshëm. - Rrezik serioz për t'u shkëputur.		**X**	**X**
2.2.2. Shtylla e timonit / korniza dhe nofulla te amortizatori drejtues	Me mjetin mbi një gropë ose në një urë ngritëse dhe peshën e mjetit në tokë, shtyje dhe tërhiqe timonin në drejtim të shtyllës, shtyje timonin në drejtime të ndryshme në kënd të drejtë me shtyllën/ nofullën. Inspektim vizual i xhiokove dhe gjendjes së lidhjeve fleksible ose nyjave universale.	a. Lëvizje e madhe lart ose poshtë e timonit.		**X**	
		b. Lëvizje e tepruar e pjesës së sipërme të shtyllës drejtuese në lidhje me boshtin e shtyllës drejtuese.		**X**	
		c. Lidhësja fleksibël në gjendje të përkeqësuar.		**X**	
		d. Fiksimi me defekt. - Rrezik serioz për t'u shkëputur.		**X**	**X**
		e. Modifikim (zëvendësim) i pasigurt[3].			**X**
2.3. Xhioko e timonit	Me mjetin mbi një grope ose në një urë ngritëse, me masën e mjetit mbi rrota, me motorin, mundësisht të ndezur për automjetet me servo përforcues dhe me rrotat në pozicionin drejt, kthe lehtësisht timonin në sens orar dhe antiorar, sa më tepër të jetë e mundur pa lëvizur	- Xhioko e tepruar e timonit (p.sh., lëvizja e cilësdo rrotë në rrethin e timonit tejkalon një të pestën e diametrit të timonit ose jo në përputhje me kërkesat[1]. - Ndikim në drejtimin e sigurt.		**X**	**X**

	rrotat. Inspektim vizual i lëvizjes boshe.				
2.4. Orientimi i rrotave (X) [2]	Kontrollo orientimin e rrotave drejtuese me pajisjet e duhura.	- Orientimi jo në përputhje me të dhënat e prodhuesit të automjetit dhe kërkesat[1]. - Ndikim në ngjarje; stabiliteti i drejtimit i reduktuar.	**X**	**X**	
2.5. Kurora kthyese e boshtit drejtues te rimorkiot	Inspektim vizual ose duke përdorur një instrument të posaçëm për të zbuluar xhiokon e rrotave.	a. Komponenti lehtësisht i dëmtuar. - Komponenti tepër i dëmtuar ose i thyer.		**X**	**X**
		b. Xhioko e tepërt. - Ndikim në ngjarje; stabiliteti i drejtimit i reduktuar.		**X**	**X**
		c. Fiksimi me defekt. - Fiksimi i dëmtuar seriozisht.		**X**	**X**
2.6. Sistemi i drejtimit elektronik (EPS)	Inspektim vizual dhe kontroll i përputhjes ndërmjet këndit të timonit dhe këndit të rrotave kur fiket dhe ndizet motori dhe/ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	a. Drita indikuese e keqfunksionimit të EPS tregon dështime të ndryshme të sistemit.		**X**	
		b. Mospërputhje ndërmjet këndit të timonit dhe këndit të rrotave. - Ndikim në drejtim.		**X**	**X**
		c. Sistemi elektronik nuk funksionon.		**X**	
		d. Sistemi tregon dështim nëpërmjet ndërfaqes elektronike të automjetit.		**X**	
3. SHIKUESHMËRIA					
3.1. Fusha e shikimit	Inspektim vizual nga pozicioni i drejtuesit të automjetit.	- Pengesa brenda fushës së shikimit të drejtuesit të automjetit që ndikojnë shikimin e tij përpara ose anash (jashtë zonës së pastrimit të fshirëseve të xhamave). - Shikueshmëria brenda zonës së fushës së pastrimit të fshirëseve të xhamave e reduktuar ose pasqyrat e jashtme nuk janë të dukshme.	**X**	**X**	
3.2. Gjendja e xhamave.	Inspektim vizual.	a. Xhama të krisur ose të çngjyrosur ose panele transparente (nëse është e lejuar) (jashtë zonës së pastrimit të pastrueseve të xhamave). - Shikueshmëria, e shkaktuar nga krisja, brenda zonës së fushës së pastrimit të fshirëseve të xhamave e reduktuar ose pasqyrat e jashtme nuk janë të dukshme.	**X**	**X**	
		b. Xhamat ose panelet transparente (përfshirë reflektimin ose cipën e ngjyrosur) nuk përputhen me specifikimet në kërkesën[1] (jashtë zonës së pastrimit të fshirëseve të xhamave). - Shikueshmëria brenda zonës së fushës së pastrimit të fshirëseve të xhamave e reduktuar ose pasqyrat e jashtme nuk janë të dukshme.	**X**	**X**	

		c. Xhamat ose paneli transparent në gjendje të papranueshme. - Shikueshmëria brenda zonës së pastrimit të fshirëseve të xhamave shumë e reduktuar.		**X**	**X**
3.3. Pasqyrat ose pajisjet retrovizore	Inspektim vizual.	a. Pasqyra ose pajisja mungon ose nuk është vendosur sipas kërkesës [1] (të paktën dy pajisje retrovizore në dispozicion). - Më pak se dy pajisje retrovizore në dispozicion.		**X** **X**	
		b. Pasqyra ose pajisja lehtësisht e dëmtuar ose e lirshme. - Pasqyra ose pajisja jofunksionale, tepër e dëmtuar, e lirshme ose e pasigurt.	**X**	**X**	
		c. Fusha e shikimit e nevojshme jo e mbuluar.		**X**	
3.4. Fshirëset e xhamave	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	a. Fshirëset e xhamave nuk funksionojnë ose nuk janë në përputhje me kërkesën[1].		**X**	
		b. Fshirësja me defekt. - Fshirësja mungon ose dukshëm me defekt.	**X**	**X**	
3.5. Pastrueset e xhamave	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	- Pastrueset nuk funksionojnë në mënyrën e duhur (mungesë e lëngut pastrues por pompa funksionon ose keqfunksionim i përçuesit të lëngut). - Pastrueset nuk funksionojnë.	**X**	**X**	
3.6. Sistemi kundër avullimit (X) [2]	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	- Sistemi nuk funksionon ose dukshëm me defekt.	**X**		
4. DRITAT, REFLEKTORËT DHE PAJISJET ELEKTRIKE					
4.1. Dritat kryesore					
4.1.1. Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	a. Drita ose burimi i dritës mungon ose me defekt.(drita / burime drite shumëfishe; në rastin e LED deri 1/3 jofunskionale). - Drita/ burimet e dritës; në rastin e LED, shikueshmëri e reduktuar seriozisht.	**X**	**X**	
		b. Sistem projeksioni lehtësisht me defekt (reflektori dhe lentet). - Sistemi projeksionit mungon ose është me defekt të rëndë (reflektori, lentet dhe xhami mbrojtës).	**X**	**X**	
		c. Feneri i fiksuar në mënyrë jo të sigurt.		**X**	
ELEMENTI	**METODA**	**ARSYET PËR DËSHTIM**	**VLERËSIMI I MANGËSIVE**		
			E vogël	E madhe	E rrezikshme
4.1.2. Orientimi	Përcakto orientimin horizontal të	a. Drejtimi i dritës nuk është brenda kufijve të përcaktuar në kërkesën[1].		**X**	

	çdo drite të shkurtër duke përdorur një pajisje për orientimin e dritave ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	b. Sistemi tregon defekt nëpërmjet ndërfaqes elektronike të automjetit.		**X**	
4.1.3. Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	a. Çelësi nuk funksionon në përputhje me kërkesat[1] (numri i dritave kryesore të ndezura në të njëjtën kohë). - Ndriçimi maksimal i lejuar i dritave të përparme i tejkaluar.	**X**	 **X**	
		b. Funksionimi i pajisjes së kontrollit i reduktuar.		**X**	
		c. Sistemi tregon defekt nëpërmjet ndërfaqes elektronike të sistemit.		**X**	
4.1.4. Përputhshmëria me kërkesën [1].	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	a. Drita, ngjyra e emetuar, pozicioni, intensiteti ose shenja nuk janë në përputhje me kërkesat [1].		**X**	
		b. Papastërti në xhamin e dritave ose në burim të dritës të cilat reduktojnë intensitetin e dritave ose ndryshojnë ngjyrën e emetuar.		**X**	
		c. Burimi i dritës dhe drita jokompatibël.		**X**	
4.1.5. Sistemi për rregullimin e lartësisë së dritave (kur është i detyrueshëm)	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit, nëse është e mundur, ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	a. Pajisja nuk funksionon.		**X**	
		b. Nuk mund të rregullohet në mënyrë manuale nga ndenjësja e ngarësit.		**X**	
		c. Sistemi tregon dështim nëpërmjet ndërfaqes elektronike të sistemit.		**X**	
4.1.6. Pajisja për pastrimin e dritave kryesore (kur është e detyrueshme)	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit, nëse është e mundur.	- Pajisja nuk funksionon. - Në rastin e dritave me shkarkim.	**X**	 **X**	
ELEMENTI	**METODA**	**ARSYET PËR DËSHTIM**	**VLERËSIMI I MANGËSIVE**		
			E vogël	E madhe	E rrezikshme
4.2. Dritat e përparme dhe të pasme të pozicionit, dritat anësore, dritat gabarite dhe dritat e ditës					
4.2.1. Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit	a. Burimi i dritës me defekt.		**X**	
		b. Xhami i dritës me defekt.		**X**	
		c. Drita e fiksuar në mënyrë të pasigurt. - Rrezik shumë serioz për të rënë.	**X**	 **X**	

4.2.2. Çelësi	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit.	a. Çelësi nuk funksionon në përputhje me kërkesën [1]. - Dritat e pasme të pozicionit dhe dritat anësorë për shënim mund të fiken kur dritat kryesore janë të ndezura.		**X** **X**	
		b. Funksionimi i pajisjes së kontrollit i reduktuar.		**X**	
4.2.3. Përputhshmëria me kërkesën [1]	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit.	a. Drita, ngjyra e emetuar, pozicioni, intensiteti ose shenja nuk janë në përputhje me kërkesën [1]. - Dritë e kuqe përpara ose dritë e bardhe mbrapa; intensiteti i dritës i reduktuar shumë.	**X**	 **X**	
		b. Papastërti në xhamin e dritave ose në burim të dritës të cilat reduktojnë intensitetin e dritave ose ndryshojnë ngjyrën e emetuar. - Dritë e kuqe përpara ose dritë e bardhe mbrapa; intensiteti i dritës i reduktuar shumë.	**X**	 **X**	
4.3. Dritat e frenave					
4.3.1. Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjate funksionimit.	a. Burim drite me defekt (burimet e shumëfishta të dritës në rastin e LED mbi 1/3 nuk funksionojnë). - Burimet unike të dritës; në rastin e LED më pak se 2/3 nuk funksionojnë. - Të gjitha burimet e dritës nuk funksionojnë.	**X**	 **X**	 **X**
		b. Xhami i dritës me defekt të lehtë (pa ndikim në dritën e emetuar). - Xhami i dritës me defekt të rëndë (drita e emetuar e reduktuar).	**X**	 **X**	
		c. Fiksimi i dritës jo në mënyrë të sigurt. - Rrezik shumë serioz për të rënë.	**X**	 **X**	
4.3.2. Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit ose duke përdorur ndërfaqen elektronike të automjetit.	a. Çelësi nuk funksionon në përputhje me kërkesën [1]. - Reagim i vonuar. - Nuk funksionon.	**X**	 **X**	 **X**
		b. Funksionimi i pajisjes kontrolluese i reduktuar.		**X**	
		c. Sistemi tregon defekt nëpërmjet ndërfaqes elektronike të automjetit.		**X**	
		d. Drita e frenit të emergjencës nuk funksionon ose funksionon në mënyrë jokorrekte.		**X**	
4.3.3. Përputhshmëria me kërkesat [1].	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	- Drita, ngjyra e emetuar, pozicioni, intensiteti ose shenja nuk janë në përputhje me kërkesat [1]. - Dritë e bardhë mbrapa; intensiteti i dritës shumë i reduktuar.	**X**	 **X**	
4.4. Treguesi i drejtimit dhe dritat sinjalizuese të rrezikut					

4.4.1. Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	a. Burim drite me defekt (burimet e shumëfishta të dritës në rastin e LED mbi 1/3 nuk funksionojnë). - Burimet unike të dritës; në rastin e LED më pak se 2/3 nuk funksionojnë.	**X**	**X**	
		b. Xhami i dritës me defekt të lehtë (pa ndikim në dritën e emetuar). - Xhami i dritës me defekt të rëndë (drita e emetuar e reduktuar).	**X**	**X**	
		c. Drita e fiksuar në mënyrë jo të sigurt. - Rrezik shumë serioz për të rënë.	**X**	**X**	
4.4.2. Çelësi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	- Çelësi nuk funksionon në përputhje me kërkesat. - Nuk funksionon.	**X**	**X**	
4.4.3. Përputhshmëria me kërkesat [1].	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	- Drita, ngjyra e emetuar, pozicioni, intensiteti ose shenja nuk janë në përputhje me kërkesat.		**X**	
4.4.4. Frekuenca e fleshimit	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	- Norma e fleshimit jo në përputhje me kërkesën [1] (frekuenca me devijim më tepër se 25%).	**X**		

4.5. Dritat e përparmë dhe të pasme të mjegullës

ELEMENTI	METODA	ARSYET PËR DËSHTIM	VLERËSIMI I MANGËSIVE		
			E vogël	E madhe	E rrezikshme
4.5.1. Gjendja dhe funksionimi	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit.	a. Burim drite me defekt (burimet e shumëfishta të dritës në rastin e LED mbi 1/3 nuk funksionojnë). - Burimet unike të dritës; në rastin e LED më pak se 2/3 nuk funksionojnë.	**X**	**X**	
		b. Xhami i dritës me defekt të lehtë (pa ndikim në dritën e emetuar). - Xhami i dritës me defekt të rëndë (drita e emetuar e reduktuar).	**X**	**X**	
		c. Drita e fiksuar në mënyrë jo të sigurt. - Rrezik shumë serioz për të rënë ose për të verbuar makinat nga drejtimi i kundërt.	**X**	**X**	
i) 24 muaj për matjen e peshës, presionit dhe nivelit të zhurmave,

ii) 24 muaj për matjen e forcave,

iii) 12 muaj për matjen e shkarkimeve të gazrave.

Tabela I (1)

Pajisjet minimale të nevojshme me qëllim kryerjen e një kontrolli teknik

Mjetet		Kategoria		Pajisjet e nevojshme për secilin nga artikujt e listuar në seksionin I														
	Masa maksimale			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1. Motoçikletat																		
		L1	P[1]	x								x	x		x	x	x	
		L3, L4	P	x								x	x		x	x	x	
		L3, L4	D[2]	x								x		x	x	x	x	
		L2	P	x	x							x	x		x	x	x	
		L2	D	x	x							x		x	x	x	x	
		L5	P	x	x							x	x		x	x	x	
		L5	D	x	x							x		x	x	x	x	
		L6	P	x	x							x	x		x	x	x	
		L6	D	x	x							x		x	x	x	x	
		L7	P	x	x							x	x		x	x	x	
		L7	D	x	x							x		x	x	x	x	
2. Mjetet për transportimin e personave																		
	Deri në 3 500 kg	M1, M2	P	x	x		x					x	x		x	x	x	x
	Deri në 3 500 kg	M1, M2	D	x	x		x					x		x	x	x	x	
	> 3 500 kg	M2, M3	P	x	x	x		x	x	x	x	x	x		x	x	x	x
	> 3 500 kg	M2, M3	D	x	x	x		x	x	x	x	x		x	x	x	x	
Mjetet		**Kategoria**		**Pajisjet e nevojshme për secilin nga artikujt e listuar në seksionin I**														
	Masa maksimale			**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**
3. Mjete për transportimin e mallrave																		

	Deri në 3 500 kg	N1	P	x	x		x					x	x		x	x	x	x
	Deri në 3 500 kg	N1	D	x	x		x					x		x	x	x	x	
	> 3 500 kg	N2, N3	P	x	x	x		x	x	x	x	x	x		x	x	x	x
	> 3 500 kg	N2, N3	D	x	x	x		x	x	x	x	x		x	x	x	x	
4. Mjetet e veçanta që vijnë nga një mjet i kategorisë N, T5																		
	Deri në 3 500 kg	N1	P	x	x		x					x	x		x	x	x	x
	Deri në 3 500 kg	N1	D	x	x		x					x		x	x	x	x	
	> 3 500 kg	N2, N3, T5	P	x	x	x		x	x	x	x	x	x		x	x	x	x
	> 3 500 kg	N2, N3, T5	D	x	x	x		x	x	x	x	x		x	x	x	x	
5. Rimorkiot																		
	Deri në 750 kg	O1		x												x		
	> 750 deri 3 500 kg	O2		x	x		x									x		
	> 3 500 kg	O3,O4		x	x	x			x	x	x					x		

[1.] Mjete me motor me ndezje të komanduar P;
[2.] Mjete me motor me ndezje të komprimuar D

ANEKSI IV
KËRKESAT MINIMALE NË LIDHJE ME KOMPETENCËN, TRAJNIMIN DHE CERTIFIKIMIN E INSPEKTORËVE

1. Kompetenca

Para autorizimit të një aplikanti për një pozicion si inspektor për të kryer kontrolle periodike teknike, autoritetet kompetente duhet të verifikojnë që ai person:

a. ka njohuri të certifikuara për automjetet rrugore në fushat e mëposhtme:

- mekanikë;
- dinamikë;
- dinamika e automjeteve;
- motorët me djegie;
- materialeve dhe përpunimin materialeve;
- elektronikë;
- elektrike;
- komponentët e automjeteve elektronike;
- aplikacionet e TI.

b. të ketë së paku tre vjet përvojë të dokumentuar ose të barasvlershme, të tilla si mentorim ose studime të dokumentuara dhe trajnimin e duhur në fushat e automjeteve rrugor të përcaktuara më sipër.

2. Trajnimi fillestar dhe rifreskues

Autoritetet kompetente duhet të garantojnë që inspektorët do të marrin trajnimin e duhur fillestar dhe rifreskues ose t'u nënshtrohen provimeve të përshtatshme, duke përfshirë elementet teorike dhe praktike, për t'u mundësuar atyre që të jenë të autorizuar për të kryer kontrolle teknike të automjeteve.

Përmbajtja minimale e trajnimit fillestar dhe rifreskues ose provimeve të përshtatshme duhet të përfshijë temat e mëposhtme:

a. Trajnimi fillestar ose provimi i përshtatshëm

Trajnimi fillestar i ofruar nga autoriteti kompetent ose nga një qendër trajnimi e autorizuar duhet të mbulojë së paku temat e mëposhtme:

i) teknologjia e mjeteve:

- sistemet e frenimit,
- sistemet e drejtimit,
- fusha e shikimit,
- instalimin e ndriçuesve, pajisjet e ndriçimit dhe komponentët elektronikë,
- boshtet, rrota dhe gomat,
- shasia dhe karroceria,
- ndikimi në mjedis dhe emetimet,
- kërkesat shtesë për automjetet speciale,

ii) metodat e kontrollit;

iii) vlerësimin e mangësive;

iv) kërkesat ligjore të aplikueshme për gjendjen e automjetit për miratim;

v) kërkesat ligjore lidhur me kontrollin teknik të mjeteve;

vi) dispozitat administrative lidhur me miratimin, regjistrimin dhe kontrollin teknik të mjetit;

vii) aplikacionet e TI lidhur me kontrollin teknik dhe administrimin.

b. Trajnimi rifreskues ose provimi i përshtatshëm

Autoriteti/qendra e autorizuar trajnimit duhet të garantojnë që inspektorët rregullisht do të marrin trajnime rifreskuese ose do t'i nënshtrohen një provimi të përshtatshëm të ofruar ose të caktuar nga autoriteti kompetent ose nga një qendër e autorizuar trajnuese.

Autoriteti/qendra trajnuese duhet të sigurojnë që përmbajtja e trajnimit rifreskues ose provimi i përshtatshëm do t'i mundësojë inspektorët të ruajnë dhe freskojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në lidhje me temat e përmendura në pikën (a), (i) deri (vii) më sipër.

3. Certifikata e kompetencës

Certifikata ose dokumentacioni ekuivalent i lëshuar ndaj një inspektor i autorizuar për të kryer kontrollet teknike të mjeteve duhet të përfshijë së paku informacionin e mëposhtëm:

- identifikimi i inspektorit (emri, mbiemri);
- kategoritë e automjeteve për të cilat inspektori është i autorizuar për të kryer kontrollet teknike;
- emri i autoritetit lëshues;
- data e lëshimit.

ANEKSI V
ORGANET MBIKËQYRËSE

Rregullat dhe procedurat në lidhje me organet mbikëqyrëse të themeluara në përputhje me nenin 14 mbulojnë kërkesat minimale në vijim:

1. Detyrat dhe aktivitetet e organeve mbikëqyrëse

Organet mbikëqyrëse kryejnë të paktën detyrat e mëposhtme:

a. Mbikëqyrja e qendrave të kontrollit:

- kontrollimi nëse janë plotësuar kërkesat minimale për mjediset dhe pajisjet e kontrollit;

- verifikimi i kërkesave të detyrueshme të subjektit të autorizuar;

b. Verifikimi i trajnimit dhe provimeve të inspektorëve:

- verifikimin e trajnimit fillestar të inspektorëve;
- verifikimin e trajnimit periodik rifreskues të inspektorëve;
- trajnimin periodik rifreskues të ekzaminuesve të organeve mbikëqyrëse;
- kryerjen ose mbikëqyrjen e provimeve.

c. Auditimi:

- paraauditimi i qendrave të kontrollit para autorizimit;
- riauditim periodik i qendrave të kontrollit;
- auditime të veçanta në rastin e parregullsive;
- auditimi i qendrave të trajnimit / ekzaminimit.

d. Monitorimi, duke përdorur masa të tilla si në vijim:

- rikontrollin e një përqindjeje të vlefshme statistikore të mjeteve të kontrolluara;
- kontrollet inkonjito (përdorimi opsional i mjeteve me defekte);
- analiza e rezultateve të kontrolleve teknike (metoda statistikore);
- kontrollet e apelimeve;
- hetimi i ankesave.

e. Validimi i rezultateve të kontrolleve teknike.

f. Propozimi i tërheqjes ose pezullimit të autorizimit të qendrave kontrolluese dhe / ose të inspektorëve:

- kur qendra ose inspektori në fjalë nuk plotëson një kërkesë të rëndësishme autorizimi;
- ku zbulohen parregullsi të mëdha;
- kur ka rezultate të vazhdueshme negative të auditimeve;
- kur ka një humbje të reputacionit të mirë nga ana e qendrës ose inspektorit në fjalë.

1. Kërkesat që kanë të bëjnë me organin mbikëqyrës

Kërkesat e zbatueshme për personelin e punësuar nga një organ mbikëqyrës duhet të mbulojnë fushat e mëposhtme:

- kompetencë teknike;
- paanshmëria;
- standarde kualifikimi dhe trajnimi.

2. Përmbajtja e rregullave dhe proçedurave

Ministria përgjegjëse për transportin përcakton rregullat dhe procedurat përkatëse, të cilat përfshijnë të paktën pikat e mëposhtme:

a. Kërkesat në lidhje me licencimin/autorizimin dhe mbikëqyrjen e qendrave të kontrollit:

- kërkesë për autorizim për të vepruar si qendër kontrolli;
- përgjegjësitë e qendrave të kontrollit;
- vizita para autorizimit, ose vizita, për të verifikuar që janë plotësuar të gjitha kërkesat;
- autorizimi i qendrave të kontrollit;
- ritestimi/audite periodike të qendrave të kontrollit;
- kontrolle periodike në qendrat e kontrollit për të parë nëse ato vazhdojnë të jenë në përputhje me rregullat dhe procedurat e zbatueshme;
- kontrolle të veçanta të paparalajmëruara bazuar mbi evidenca ose audite të qendrave të kontrollit;
- analizën e të dhënave të kontrolleve për të parë nëse ekzistojnë dëshmi për mospërputhje me rregullat dhe procedurat e zbatueshme;
- tërheqja ose pezullimi i licencave/autorizimeve të dhëna për qendrat e kontrollit.

b. Inspektorët e qendrave të kontrollit:

- kërkesat për t'u bërë inspektor i certifikuar;
- trajnimi fillestar, trajnimi rifreskues dhe provimet;
- tërheqja ose pezullimi i certifikimit të inspektorëve.

c. Pajisjet dhe mjediset:

- kërkesat për pajisjet e kontrollit;
- kërkesat për mjediset e kontrollit;
- kërkesat për shenjëzimin;
- kërkesat për mirëmbajtjen dhe kalibrimin e pajisjeve të kontrollit;
- kërkesat për sistemet kompjuterike.

d. Organet mbikëqyrëse:

- kompetencat e organeve mbikëqyrëse;
- kërkesat e aplikueshme për stafin e organeve mbikëqyrëse;
- apelimet dhe ankesat.

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesat nr. 41411/11 dhe 58014/16,

RENALDO BREGU KUNDËR SHQIPËRISË DHE NATASHA NOKSHIQI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 28 shtator 2021, si Komision i përbërë nga:

María Elósegui, *kryetare,*
Frédéric Krenc
Darian Pavli, *gjyqtarë,*
dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

Pasi morën në konsideratë kërkesat e mësipërme të paraqitura më 30 qershor 2011 dhe 30 shtator 2016, respektivisht,

Duke marrë në konsideratë parashtrimet e paraqitura nga Qeveria e paditur, dhe parashtrimet paraqitur si përgjigje ndaj të parave nga kërkuesit,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Kërkuesi në çështjen e parë (kërkesa nr. 41411/11), z. Renaldo Bregu, është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1979, i cili jeton në Tiranë ("kërkuesi i parë"). Kërkuesi në çështjen e dytë (kërkesa nr. 58014/16), znj. Natasha Nokshiqi, është një shtetase shqiptare, e cila ka lindur në vitin 1972 dhe jeton në Tiranë ("kërkesa e dytë"). Kërkuesit u përfaqësuan përpara Gjykatës nga z. T. Aleksandridis dhe z. D. Matlija, avokatë, të cilët e ushtrojnë profesionin në Tiranë.

2. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjentët e saj të asaj periudhe, znj. A. Hicka, z. A. Metani, znj. E. Muçaj dhe më pas nga znj. B. Lilo, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjeve, sipas parashtrimeve të palëve, mund të përmblidhen si më poshtë:

1. Kërkesa nr. 41411/11: Bregu kundër Shqipërisë

3. Në periudhën kur u paraqitën ankesat, kërkuesi i parë merrte një shumë mujore prej 6,340 ALL si i papunë (lekë shqiptarë – rreth 55 euro, EUR). Pas pagesës së shumës së fundit si i papunë, në një periudhë të caktuar midis muajit dhjetor 2010 dhe janar 2011, kërkuesi i parë dëshironte ta kundërshtonte shumën e ulët përpara gjykatave vendase, dhe të ankohej për faktin se shuma kishte ndaluar së paguari pas një viti.

4. Megjithatë, për shkak të taksës së padisë, e cila ishte 12,000 ALL (rreth 98 EUR), dhe duhej të paguhej në periudhën e dorëzimit të padisë, kërkuesi nuk paraqiti asnjë padi për këtë gjë.

2. Kërkesa nr. 58014/16: Nokshiqi kundër Shqipërisë

5. Më 30 nëntor 2014, kërkuesja e dytë u shoqërua në një stacion policie në Tiranë, me pretendimin se kishte bërë një lidhje të paligjshme elektrike. Ajo mori vajzën e saj, minorene në moshë, në stacionin e policisë , pavarësisht udhëzimeve të oficerëve të policisë së ajo nuk duhej ta merrte vajzën me vete. Më 1 tetor 2015, prokuroria e Tiranës vendosi t'i ndërpriste procedimet penale kundër kërkueses.

6. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesja paraqiti një kërkesë për dëmshpërblim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë ("Gjykata e Shkallës së Parë"), ku kërkonte kompensim për dëm psikologjik të shkaktuar ndaj vajzës së saj nga policia. Pas një kërkese për ndihmë juridike falas, më 8 shkurt 2016, Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike ("KSHNJ") e pranoi kërkesën, në mënyrë që kërkuesja të mund të përfitonte nga ndihma juridike në formën e përfaqësimit ligjor përpara gjykatave vendase. Kostot e përfaqësimit ligjor do të mbuloheshin nga KSHNJ-ja.

7. Gjatë seancës paraprake, më 17 shkurt 2016, Gjykata e Shkallës së Parë konstatoi të meta në kërkesën për dëmshpërblim, pasi kërkuesja nuk kishte paguar taksën e padisë, dhe e ktheu kërkesën, në mënyrë që kërkuesja të mund të korrigjonte të metat. Pas pagesës, Gjykata e Shkallës së Parë rifilloi procedimet.

8. Më 17 mars 2016, Gjykata e Shkallës së Parë caktoi dy ekspertë, kostot e të cilëve do të duhej të mbuloheshin nga kërkuesja, për të vlerësuar shëndetin fizik dhe psikologjik të vajzës së kërkueses.

9. Më 31 mars 2016, kërkuesja kërkoi që të tërhiqte kërkesën për dëmshpërblim për shkak të pamundësisë së saj për të paguar tarifën e ekspertëve. Në të njëjtën datë, Gjykata e Shkallës së Parë e pranoi kërkesën dhe vendosi pushimin e

çështjes. Vendimi parashikonte se një apelim i posaçëm mund të paraqitej kundër tij (shih edhe paragrafin 13 më poshtë). Konstatohet se, ndaj këtij vendimi nuk u paraqit asnjë apelim.

B. Ligji dhe praktika përkatëse e brendshme

1. Kodi i Procedurës Civile (KPC)

10. Neni 102 parashikon se tarifat gjyqësore përbëhen nga taksa mbi aktet, si edhe kosto e shpenzime të tjera ligjore. Sipas nenit 104, i cili u shfuqizua në vitin 2017, taksa mbi aktet u përcaktua në mbështetje të vlerës së padisë, e përcaktuar nga paditësja, dhe do të paguhej në kohën kur do të paraqitej padia (shih edhe nenin 156). Në rastin e mospagesës, gjyqtari i vetëm e kthen padinë te paditësja pa ndërmarra hapa të tjerë, sipas nenit 154/a, duke përcaktuar se të metat duhet të korrigjohen brenda afatit të parashikuar. Vendimi mund të apelohet me anë të një apeli të posaçëm.

11. Neni 105/b, hyrë në fuqi në vitin 2001, parashikon se individët të cilët përjashtohen nga pagesa e taksës së akteve, do të përjashtohen nga pagesa e kostove dhe e shpenzimeve të tjera. Sipas nenit 158/a, gjykata, në një seancë paraprake, mund të vendosë ta përjashtojë një paditës nga pagesa e taksës së akteve për rastet e parashikuara nga ligji.

12. Neni 105 parashikon se tarifat për ekspertët duhet të paguhen paraprakisht nga pala e cila kërkon raportimin e një eksperti. Megjithatë, gjykata mund të urdhërojë palën tjetër të paguajë tarifat e ekspertit, ose ato mund të paguhen midis palëve në procedime, nëse rrethanat e çështjes dhe situata financiare e palëve e kërkojnë një gjë të tillë.

13. Neni 158/a parashikon se një apelim i posaçëm mund të paraqitet ndaj vendimit për pushimin e çështjes. Sipas nenit 443, apelimi i posaçëm do të duhej të paraqitej brenda pesë ditëve nga vendimi për pushimin e çështjes.

2. Ligji për Ndihmën Juridike 2008, i ndryshuar (ligji nr. 10039, i datës 22 dhjetor 2008, i ndryshuar nga ligjet nr. 143/2013 dhe 77/2014)

14. Ligji për Ndihmën Juridike 2008 ishte në fuqi deri më 1 qershor 2018, kur u shfuqizua nga Ligji për Ndihmën Juridike (ligji nr. 111, i datës 14 dhjetor 2017). Neni 11 parashikon dy lloje të ndihmës juridike: ndihma juridike parësore (informacion për legjislacionin dhe sistemin ligjor, të drejtat dhe detyrimet e individëve, dhe ndihma në përgatitjen e dokumenteve ligjorë), dhe ndihma juridike dytësore (këshilla ligjore dhe përfaqësim në procedimet penale, civile dhe administrative). Sipas nenit 12, i ndryshuar në vitin 2013, ndihma juridike falas mund të ofrohej edhe në formën e përjashtimit nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe e kostove e shpenzimeve të tjera, si për shembull tarifa e ekspertit.

15. Ligji për Ndihmën Juridike 2008, parashikon krijimin e KSHNJ-së, i cili është përgjegjës për, midis të tjerash, shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike (neni 6 dhe 10). Sipas nenit 16(4) dhe (6), ndryshuar në vitin 2014, një formular i posaçëm aplikimi do të duhej të përgatitej për ndihmën juridike në formën e përjashtimit nga pagesa për tarifën gjyqësore dhe kostot e shpenzimet e tjera. Neni 21/1, shtuar në vitin 2013, parashikon se KSHNJ-a duhet t'i shqyrtojë kërkesat për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga taksa mbi aktet dhe kostot e shpenzimeve të tjera brenda dhjetë ditëve nga marrja e ndihmës. Nëse KSHNJ-a nuk merr një vendim ose e rrëzon kërkesën, gjykata, në një seancë paraprake, mund të vendosë për përjashtimin e të paditurit nga taksa mbi aktet dhe kostot e shpenzimet e tjera, në rast se plotësohen kushtet sipas seksionit 13(1)(c). Nëse KSHNJ-a gjykon se paditësi nuk ka mundësi të paguajë taksën mbi aktet për shkak të situatës së tij financiare, KSHNJ-a mund të urdhërojë që të shtyhet afati për pagesën, ose që pagesa të bëhet me këste, edhe nëse nuk përmbushen kushtet e parashikuara në nenin 13(1)(c).

16. Neni 13(1)(c), i ndryshuar me nenin 2014, parashikon se një person mund të përfitojë nga ndihma juridike falas, nëse ai ose ajo nuk ka mjetet e duhura për të paguar taksat mbi aktet dhe kostot e shpenzimet e tjera, dhe është përfitues i asistencës sociale, ose i përmbush kërkesat për ta përfituar një ndihmë të tillë, ose nëse ka qenë viktimë e dhunës në familje ose e trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Praktika gjyqësore e brendshme

17. Më 27 shkurt 2013, përpara miratimit të ndryshimeve të vitit 2013 dhe 2014, në Ligjin për Ndihmën Juridike, Gjykata Kushtetuese vendosi me shumicë se respektimi i parashikimit në ligjin vendas për shlyerjen e taksës mbi aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës, edhe nga njerëzit pa mjete financiare, nuk përbën një shkelje të të drejtave të njeriut për akses në një gjykatë. Më tej në vendim përcaktohet se paditësit/es që

paraqet një padi i kërkohet të paguajë taksën mbi aktet paraprakisht si përqindje e vlerës së padisë. Një gjyqtar i zakonshëm, në mbështetje të rrethanave të çështjes dhe situatës financiare të paditësit/es, mund të vendos, sipas çështjes përkatëse, ta përjashtojë atë nga taksa mbi aktet për të garantuar të drejtën e aksesit në gjykatë, në një rast të tillë, taksa mbi aktet paguhet nga buxheti i Shtetit. Në vijim, Gjykata Kushtetuese gjykon se KSHNJ-ja do të duhet të ofrojë ndihmë juridike për disa kategori të caktuara individësh, sipas Ligjit për Ndihmë Juridike.

18. Opinioni kundërshtues përcakton se ka pasur një shkelje të të drejtës së individit për akses në gjykatë, për sa i përket kërkesës për të paguar taksën mbi aktet, sepse legjislacioni i brendshëm nuk parashikon përjashtimin nga pagesa e taksës mbi aktet gjyqësore për personat pa mjete financiare. Ajo gjykon se kërkesa për të paguar taksën mbi aktet është *sine qua non* për vijimin e procedimeve. Gjithashtu, ajo përcakton se interpretimi i shumicës, në lidhje me dispozitat e KPC-së dhe Ligjit për Ndihmën Juridike lë hapësirë për arbitraritet, në mungesë të një kuadri të qartë ligjor për kriteret e përjashtimit.

ANKESAT

19. Kërkuesit u ankuan në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, duke pretenduar se e drejta e tyre për akses në gjykatë ishte kufizuar në mënyrë të pajustifikueshme për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar tarifat gjyqësore.

LIGJI

A. Bashkimi i kërkesave

20. Në mbështetje të Rregullit 42§1 të Rregullores së Gjykatës, Gjykata vendos të bashkojë kërkesat, duke marrë në konsideratë kuadrin e tyre të ngjashëm faktik dhe ligjor.

B. Ankesat e kërkuesve

21. Në ankesën e tyre për shkelje të së drejtës së tyre për akses në gjykatë, kërkuesit u mbështetën në nenin 6§1 të Konventës, në pjesët përkatëse të cilat parashikojnë si më poshtë:

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ... nga një gjykatë ...".

1. Parashtrimet e palëve

a) Në lidhje me kërkesën nr. 41411/11

22. Qeveria ngriti tre kundërshti në lidhje me pranueshmërinë e ankesës së kërkuesit të parë. Fillimisht, Qeveria parashtroi se kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit. Së dyti, ata u shprehën se kërkuesi i parë nuk kishte statusin e viktimës, duke qenë se nuk ishte e qartë se si ishte prekur personalisht nga parashikimet ligjore që po kërkonte të kundërshtonte. Së treti, Qeveria shtonte se kërkuesi i parë nuk kishte iniciuar kurrë procedime përpara gjykatave vendase për të kundërshtuar shumën për papunësinë, dhe as nuk kishte kërkuar përjashtimin nga taksa mbi aktet për shkak të pamundësisë së tij financiare për ta paguar.

23. Kërkuesi i parë u përgjigj se ai e kishte paraqitur kërkesën brenda afatit gjashtëmujor, i cili kishte nisur të përllogaritej ose më 10 janar 2011, kur i ishte paguar kësti i fundit i shumës për statusin e të papunit, ose në datën kur u parashkrua e drejta e tij për të paraqitur një padi përpara gjykatave vendase. Për më tepër, ai parashtroi se ishte ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zbatimi i ligjit të brendshëm që parashikon dhënien e shumës për papunësinë. Detyrimi statutor për të paguar tarifën mbi aktet e kishte penguar të kundërshtonte ligjin e brendshëm, përpara gjykatave vendase. Së fundmi, përpjekjet e tij për të paraqitur një padi do të kishin qenë të kota, pasi nuk ekzistonte një praktikë gjyqësore, në të cilën të ishte garantuar përjashtimi nga taksa mbi aktet.

b) Në lidhje me kërkesën 58014/16

24. Qeveria parashtroi se kërkuesja e dytë nuk kishte bërë kërkesë për përjashtim nga pagesa e tarifës së ekspertëve. Pavarësisht pretendimit të saj se e kishte bërë diçka të tillë verbalisht, në procesverbalet e të gjitha seancave nuk u gjet asnjë e dhënë e tillë. Gjithashtu, ajo nuk kishte paraqitur asnjë provë për të vërtetuar varfërinë e saj. Mosparaqitja e një kërkesë të tillë nga kërkuesja e dytë e kishte bërë të pamundur për Gjykatën e Shkallës së Parë të vlerësonte situatën e saj dhe ta vlerësonte kërkesën sipas ligjit vendas.

25. Kërkuesja e dytë parashtroi se ajo kishte bërë një kërkesë verbale që të përjashtohej nga tarifa e ekspertëve. Kërkesa e saj për ta tërhequr kërkesën për shpërblim mbështetej në varfërinë e saj, dhe kjo nënkuptonte se ky fakt i ishte bërë i ditur gjykatës. Edhe nëse hamendësohej se një kërkesë e tillë nuk ishte bërë verbalisht nga përfaqësuesi i saj ligjor, duke qenë se ai ishte një avokat i ndihmës juridike, përgjegjësia i mbeste Shtetit. Sipas këndvështrimit të saj, Gjykata e Shkallës së Parë duhej të kishte shqyrtuar situatën e saj financiare me iniciativën e vet, përderisa fakti se

kërkuesja përfitonte nga ndihma juridike ishte tregues i varfërisë së saj. Kërkuesja e dytë parashtroi se nuk kushte mjet efikas në praktikën gjyqësore.

2. Vlerësimi i Gjykatës

26. Si fillim, Gjykata vlerëson se për sa i përket kundërshtimeve të ngritura nga Qeveria, dhe përpara se të merret në shqyrtim themeli i ankesave të kërkuesve, do të duhet të përcaktohet nëse kërkuesit kanë respektuar nenin 35 të Konventës, dhe veçanërisht, kërkesën për shterimin e mjeteve të brendshme të parashikuar në nenin 35§1 të Konventës. Për këtë arsye, ajo do ta shqyrtojë këtë çështje si më poshtë, për çdo kërkesë.

a) Parime të përgjithshme

27. Gjykata thekson se sipas praktikës së saj gjyqësore të mirëpërcaktuar, periudha gjashtëmujore fillon që prej vendimit të formës së prerë në procesin e shterimit të mjeteve të brendshme (shih *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 46477/99, GJEDNJ 2002-II).

28. Në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme, Gjykata ka përcaktuar se ata persona të cilët dëshirojnë të mbështeten në juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës, për sa ka të bëjë me ankesat kundër Shtetit, janë të detyruar të përdorin fillimisht mjetet e parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor (shih për shembull *Akdivar dhe të Tjerët kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, §65, *Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve* 1996-VI). Atëherë, detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme parashikon që një kërkues të përdorë normalisht përdorimin e mjeteve, të cilat janë të disponueshme dhe të mjaftueshme, sipas ankesave të tij ose të saj në mbështetje të Konventës. Ekzistenca e mjeteve në fjalë duhet të jenë mjaftueshëm të sigurta jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, sepse në të kundërt, ato nuk do të kenë aksesueshmërinë dhe efikasitetin e nevojshëm (ibid., parag. 66).

29. Në mënyrë që një mjet të jetë efikas, ai duhet të kompensojë në mënyrë të drejtpërdrejtë shtetin e kundërshtuar dhe duhet të garantojnë perspektiva të arsyeshme suksesi. Megjithatë, ekzistenca e dyshimeve për perspektivën e suksesit të një mjeti të caktuar, i cili nuk është dukshëm i pavlerë, nuk është një arsye e vlefshme për të mosshteruar mjetin e korrigjimit (shih *Pasquini kundër San Marinos*, nr. 50956/16, § 119, 2 maj 2019).

30. Është detyrë e Qeverisë, që pretendon mosshterimin, t'i parashtrojë Gjykatës se mjeti ka qenë efikas, i disponueshëm në teori dhe në praktikë në periudhën në fjalë. Pasi një aspekti i tillë të jetë justifikuar, i mbetet kërkuesit të provojë se mjeti i parashtruar nga Qeveria në fakt është shteruar, ose për disa arsye ka qenë i papërshtatshëm dhe jo efikas për rrethana të caktuara të çështjes, ose se kanë ekzistuar rrethana të caktuara që e çlirojnë atë nga kjo kërkesë (shih *Vućković dhe të Tjerët kundër Serbisë (*kundërshtimi paraprak*)* [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerët, §77, 25 mars 2014).

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në kërkesat në fjalë

i. Në lidhje me kërkesën nr. 41411/11

31. Gjykata thekson se kërkuesi i parë dëshironte ta kundërshtonte shumën mujore si i papunë. Megjithatë, ai nuk ndërmori asnjë procedim ku të argumentonte se shuma e taksës mbi aktet ishte penguese.

32. Gjithashtu, Gjykata argumenton se neni 105/b i KPC, i hyrë në fuqi në vitin 2001, parashikon mundësinë që paditësi të përjashtohet nga taksa gjyqësore pasi të paraqesë padinë. Kur ky nen lexohet së bashku me nenin 158/a të KPC-së, gjykata e zakonshme mund të vendosë në një seancë paraprake ta përjashtojë paditësin nga taksa mbi aktet pas paraqitjes së padisë (shih paragrafin 11 më sipër). Megjithatë, kërkuesi nuk ia mundësoi vetes një mjet të tillë, pasi ai nuk ndërmori asnjë procedim.

33. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e kërkuesit se, në mungesë të një praktikë të qartë gjyqësore të brendshme, ky mjet ishte jo efikas. Në një sistem ligjor ku të drejtat themelore mbrohen nga Kushtetuta dhe ligji, është detyrë e individit të pakënaqur të testojë shtrirjen e asaj mbrojtjeje dhe të lejojë gjykatat e brendshme t'i venë në zbatim ato të drejta, dhe, aty ku është e mundur, t'i përdorin ato në ushtrimin e fuqisë së tyre për interpretim (shih *A, B dhe C kundër Irlandës* [DHM], nr. 25579/25, § 142, GJEDNJ 2010). Nëse kërkuesi i parë do të kishte dyshime për mundësinë e marrjes së një vendimi gjykate, në lidhje me përjashtimin e tij nga taksa gjyqësore, i mbetej atij të adresonte këto dyshime duke iu drejtuar gjykatave vendase. Gjykata përsërit se ajo nuk mund të zërë vendin e gjykatave vendase, pasi ato janë në pozita më të mira të shqyrtojnë dhe të

vlerësojnë rrethanat specifike që kanë të bëjnë me pretendimet e kërkuesit. Është detyra kryesore e autoriteteve vendase, më konkretisht e gjykatave, që të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin e brendshëm, duke qenë se, për sa i përket natyrës së gjërave, autoritetet kombëtare janë të kualifikuara për të zgjidhur problematikat që dalin në lidhje me këtë situatë (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, § 149, 20 mars 2018).

34. Në të tilla rrethana, për sa i përket mjetit të parashikuar në nenet 105/b dhe 158/a të KPC-së, i takon kërkuesit të parë të paraqesë një padi në gjykatat vendase dhe të testojë masën e atij mjeti. Në fakt, kërkuesi nuk mori asnjë hap në mënyrë që të kundërshtonte shumën e mbështetjes financiare që i jepej si i papunë, veçanërisht që t'i mundësonte gjykatave vendase të vlerësonin varfërinë e tij *vis-a-vis* kërkesës ligjore për të paguar taksën mbi aktet.

35. Në vijim, kërkesa e kërkuesit të parë duhet të rrëzohet sipas nenit 35§§1 dhe 4, të Konventës për mosshterim të mjeteve të brendshme.

ii. Në lidhje me kërkesën nr. 58014/16

36. Gjykata vëren se kërkuesja e dytë, së cilës i është ofruar ndihmë juridike në formën e përfaqësimit ligjor dhe pagesën e taksës gjyqësore, paraqiti një kërkesë për shpërblim. Në vijim, ajo e tërhoqi kërkesën për shkak të pamundësisë së saj për të paguar tarifën e ekspertëve, pa kërkuar përjashtimin nga pagesa e saj. Kështu, Gjykata do të gjykojë nëse ligji i brendshëm ofronte një mjet në rastin e kërkueses së dytë.

37. Gjykata vëren se, sipas Ligjit për Ndihmën Juridike 2008, KSHNJ-ja kishte fuqinë që t'i shqyrtonte kërkesat për ndihmë juridike në formën e, midis të tjerash, përjashtimit nga pagesa e kostove dhe shpenzimeve, si për shembull tarifa e ekspertit. Megjithatë, në çështjen në fjalë, nuk ka indicie që kërkuesja të ketë ndërmarrë hapa për ta paraqitur një kërkesë të tillë për ndihmë juridike te KSHNJ-ja, i cili e ka pranuar tashmë kërkesën e saj për ndihmë juridike në formën e përfaqësimit ligjor.

38. Në çdo rast, Ligji për Ndihmën Juridike i vitit 2008, parashikon se gjykata, mund të vendosë në një seancë paraprake, në lidhje me përjashtimin e kërkueses nga kostot dhe shpenzimet gjyqësore, si për shembull tarifa e ekspertëve, nëse KSHNJ-ja nuk ka marrë një vendim ose ka rrëzuar kërkesën për ndihmë juridike. Detyrimi i gjykatës së brendshme buron nga neni 105 i Kodit të Procedurës Civile (shih paragrafin 12 më sipër). Në çështjen konkrete, palët nuk dakordësohen për faktin nëse kërkuesja ka bërë një kërkesë verbale për përjashtim nga pagesa e tarifës së ekspertëve përpara Gjykatës së Shkallës së Parë. Pasi shqyrtoi dokumentet në dosjen e çështjes, Gjykata nuk ka gjetur të dhëna që të bëjnë të besosh te pretendimi i kërkueses se ajo e ka bërë një kërkesë të tillë. Duke mos e bërë një kërkesë, kërkuesja nuk i ka dhënë Gjykatës së Shkallës së Parë mundësinë që të vlerësojë situatën e saj financiare, edhe në mbështetje të nenit 105 të KPC-së, i cili parashikon se gjykata e zakonshme, për sa i përket rrethanave të një çështje dhe të situatës financiare të palëve, mund të urdhërojë, midis të tjerash, që pagesa e tarifës së ekspertëve të mbulohet nga pala tjetër në procedime.

39. Në vijim, Gjykata i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese, i cili u lëshua në vitin 2013, dhe sqaron se gjykatat e zakonshme mund të shqyrtojnë kërkesat për përjashtim nga pagesa e taksës mbi aktet, dhe *mutatis mutandis,* tarifa e ekspertëve. Mungesa e pretenduar e praktikës gjyqësore përkatëse mund të jetë edhe për faktin se problematika është paraqitur rrallë përpara gjykatave vendase për shqyrtim. Gjykata ë nënvizuar ekzistencën e dyshimeve në lidhje me perspektivën e suksesit të një mjeti të posaçëm, i cili dukshëm nuk është i kotë, ose nuk është një arsye e vlefshme për të mos e ndjekur atë (shih paragrafin 29 më sipër). Në çështjen konkrete, nëse kërkuesja ka pasur dyshime për mundësinë se mund të përjashtohej nga pagesa e tarifës së ekspertëve sipas fuqisë së Ligjit për Ndihmën Juridike 2008, dhe nenit 105 të KPC-së, i takonte asaj t'i kalonte ato dyshime duke i paraqitur një kërkesë KSHNJ-së dhe/ose Gjykatës së Shkallës së Parë. Nisur nga fakti se kërkueses i është dhënë ndihmë juridike me anë të përfaqësimit ligjor, Gjykatës nuk i takonte të spekulonte për situatën e saj financiare, dhe aq më tepër pasi ajo kishte paguar taksën gjyqësore. Së pari, i takon Gjykatës së Shkallës së Parë të përcaktonte një çështje të tillë, duke qenë se gjykatat vendase janë, nga vet natyra e gjerave, veçanërisht të kualifikuara për të zgjidhur një çështje që ngrihet përpara tyre.

40. Së fundmi, edhe nëse mendohet se kërkuesja ka bërë një kërkesë verbale për përjashtim nga pagesa e tarifës së ekspertëve, i takonte kërkueses të

apelonte kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë që e pushoi çështjen e saj (shih paragrafët 9 dhe 13 më sipër).

41. Si përfundim, Gjykata është e mendimit se kërkuesja e dytë nuk u dha gjykatave vendase mundësinë që të korrigjonin shkeljen e hamendësuar me anë të sistemit ligjor të Shtetit të Paditur. Si pasojë, edhe kërkesa në lidhje me kërkuesen e dytë duhet të rrëzohet sipas nenit 35§§1 dhe 4, të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime,

Vendos t'i bashkojë kërkesat,

I deklaron, kërkesat të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 21 tetor 2021.

Olga Chernishova **Marta Elósegui**
ZËVENDËSREGJISTRARE KRYETARE

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 47401/15

MYSLYM NELA KUNDËR SHQIPËRISË
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë) e mbledhur më 7 tetor 2021, si Komision, i përbërë nga:

Dmitry Dedov, *kryetare,*

Peeter Roosma

Andreas Zünd, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e seksionit,*

pasi morën në konsideratë kërkesën e paraqitur më 21 shtator 2015;

duke marrë në konsideratë parashtrimin e paraqitur nga Qeveria e paditur, e cila i kërkon Gjykatës të përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkuesit paraqiten në tabelën bashkëngjitur.

Ankesat e kërkuesit sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile të pushuara dhe mungesa e një mjeti efikas të brendshëm në këtë aspekt, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë ("Qeveria").

LIGJI

Pas përpjekjeve të pasuksesshme për të arritur një zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme për zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga kërkesa.

Në deklaratë, Qeveria pranoi kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve civile të pushuara dhe mungesën e një mjeti efikas të brendshëm, në lidhje me këtë aspekt. Qeveria parashtroi se në nëntor 2017, kishte hyrë në fuqi një mjet parandalues dhe efikas, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve. Qeveria ofronte t'i paguante kërkuesit shumën e detajuar në tabelën bashkëngjitur, shumë e cila do të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rastin e mospagimit të asaj shume brenda periudhës tremujore të sipërpërmendur, Qeveria ndërmerrte të paguante interesin e thjeshtë, që nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, në normën e barabartë me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje, për sa më sipër, Qeveria ftoi Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1(c) të Konventës.

Kërkuesi nuk pranoi kushtet e deklaratës të njëanshme të Qeverisë, duke u ankuar se shuma e propozuar ishte shumë e vogël.

Gjykata parashtron se neni 37§1(c) i jep mundësinë ta nxjerrë çështjen nga lista e saj, nëse "... për ndonjë arsye të parashikuar nga Gjykata, nuk justifikohet të vijohet shqyrtimi i kërkesës". Për këtë arsye, ajo mund t'i përjashtojë kërkesat sipas nenit §1(c), në mbështetje të një deklarate të njëanshme të Qeverisë së paditur, edhe nëse kërkuesi dëshiron të vijojë shqyrtimi i çështjes (shih, veçanërisht, vendimin *Tahsim Acar kundër Turqisë* (kundërshtimet paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§75–77, GJEDNJ 2003-VI. Gjithashtu, Gjykata ka një praktikë gjyqësore të mirëpërcaktuar dhe të qartë, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve civile (shih, midis të tjerash, *Scordino kundër Italisë (nr. 1)* [DHM], nr. 36813/97, §134–

227, GJEDNJ 2006-V, dhe *Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë* nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, §88–92, 1 prill 2014).

Duke pasur në konsideratë parashtrimet në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – i cili është në përputhje me shumat e dhëna në çështje të ngjashme – Gjykata gjykon se nuk është e justifikuar që të vijojë më tej me shqyrtimin e kërkesës (neni 37§1(c)). Për më tepër, Gjykata merr në konsideratë mjetin e ri në legjislacionin shqiptar, në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedimeve. Kështu, ajo nënvizon se respektimi i të drejtave të njeriut, sipas përkufizimit ë Konventës dhe të Protokolleve në të, nuk parashikon vijimin me shqyrtimin e kërkesës (neni 37§1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson, se, nëse Qeveria nuk respekton kushtet në deklaratën e tyre të njëanshme, kërkesa mund të rikthehet në listë, sipas nenit 37§2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vend.), nr. 18369/07, 4 mars 2008.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime:

Mban në konsideratë kushtet e deklaratës së Qeverisë së Paditur dhe organizimet për garantimin e përputhshmërisë me masat e marra si më sipër.

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1(c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 28 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina	**Dmitry Dedov**
ZËVENDËSREGJISTRARE E PËRKOHSHME	KRYETAR

SHTOJCË
KËRKESË E CILA PARASHTRON ANKESA SIPAS NENIT 6§1 TË KONVENTËS
(KOHËZGJATJE E TEPRUAR E PROCEDIMEVE CIVILE)

Kërkesa nr. **Data e paraqitjes**	**Emri i kërkuesit** **Viti i lindjes**	**Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë**	**Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot e shpenzimet për kërkues (në euro)[2]**
47401/15, 21.9.2015	**Myslym Nela** 1951	2.7.2021	2.300

[2] Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 3824/16

EDMOND ZHUPA KUNDËR SHQIPËRISË

(Shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 7 tetor 2021, si Komision i përbërë nga:

Dmitry Dedov, *kryetar,*

Peeter Roosma,

Andreas Zünd, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

Pasi morën në konsideratë kërkesën e paraqitur më 11 janar 2016,

Duke marrë në konsideratë parashtrimin e paraqitur nga Qeveria e paditur, e cila i kërkon Gjykatës të përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve dhe përgjigjen e kërkuesit si përgjigje ndaj këtij parashtrimi,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkuesit paraqiten në tabelën bashkëngjitur.

Ankesat e kërkuesit sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë ("Qeveria").

Qeveria parashtroi një deklaratë me fokus zgjidhjen e problematikave të ngritura nga këto ankesa. Në vijim, Qeveria i kërkoi Gjykatës të përjashtonte kërkesën.

Në deklaratë, Qeveria pranonte kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile të ndërprera. Qeveria parashtroi se në nëntor 2017 kishte hyrë në fuqi një mjet i ri parandalues dhe detyrues në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve. Qeveria ofronte t'i paguante kërkuesit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur dhe e ftonte Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve, sipas nenit 37§1 (c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në vlerën monetare të Shtetit të Paditur, në normën e aplikueshme në datën e pagesës, dhe do të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagesës së kësaj shume brenda periudhës së sipërpërmendur tremujore, Qeveria ndërmerrte të paguante interesin e thjeshtë mbi shumën, që nga përfundimi i periudhës deri në pagesën e saj të plotë, në një normë të barabartë me normën huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës kur shuma nuk është paguar, plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuesi informoi Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës.

LIGJI

Gjykata konstaton se, pas dakordësimit të shprehur të kërkuesit, për kushtet e parashtrimit të bërë nga Qeveria, çështja duhet të trajtohet si një zgjidhje miqësore midis palëve.

Për këtë arsye, Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo gjykon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas përkufizimit të Konventës dhe Protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për shqyrtimin e justifikuar të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime:

Vendos ta heqë kërkesën nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 28 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina ZËVENDËSREGJISTRARE E PËRKOHSHME

Dmitry Dedov KRYETAR

SHTOJCË

KËRKESË E CILA PARASHTRON ANKESA SIPAS NENIT 6§1 TË KONVENTËS

(Kohëzgjatje e tepruar e procedimeve civile)

Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuesit Viti i lindjes	Data e marrjes së deklaratave të Qeverisë	Data e marrjes së dakordësimit të kërkuesit	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot, dhe shpenzimet për kërkues[3]
3824/16 11.1.2016	**Edmond ZHUPA** 1958	2/7/2021	7.9.2021	2.300

[3] Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.

VENDIM
Nr. 3, datë 12.11.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar; si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret Shtetëror'", KDZH-ja e ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, u mblodh me datë 12.11.2021, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH-së,

VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

- Fondi 14/APSTR (struktura), viti 1990

Dosjet nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 12, 14, 16, 17, 18. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 20. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 22, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 32, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 62, 63, 64, 65, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 77, 78, 81, 82, 84, 86, 87, 88, 89, 90, 92, 93, 94, 95, 97, 98, 99, 102, 103, 104, 105, 106, 108, 109, 110, 111, 112. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 113. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 114, 115, 117. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 118. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 119, 120, 121. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 122. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosja 124. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 125. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 127, 128, 129, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 143. Niveli i klasifikimit "T Sekret". Dosjet 146, 147, 148, 149, 155, 156, 157. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosjet 158, 159, 160. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 161, 162, 163, 164. Niveli i klasifikimit, "Sekret". Dosja 165. Niveli i klasifikimit, "T. sekret". Dosjet 166, 167, 168, 169, 170, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 191, 193, 194, 195, 196, 198, 201, 202, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 221, 222, 223, 224, 226, 227, 228, 232, 233, 238, 239, 241, 243, 245, 249, 262, 263, 265, 266, 267, 277, 280, 281, 282, 287, 308, 310. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 312. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 313, 322, 323, 324, 328, 332, 333, 339, 348, 351, 356, 358, 359, 360, 362, 363, 366, 367, 368, 369, 373, 376, 380, 381, 389, 404, 405, 409, 436, 450, 453, 455, 458, 466, 477, 481, 483, 486. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 490. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 491, 492. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 497. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 499, 503, 507. Niveli i klasifikimit "Sekret".

Dosjet deklasifikohen plotësisht, sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika "b", të VKM-së nr. 662, date 15.11.2017.

2. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

3. Një kopje e bibliografisë t'i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 181
Datë: 2021/11/23 14:26:38
e87cc2e0-5bd0-451e-b280-995fb690d80e

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 384 lekë